



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 17 (827821)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 28 prill 2023


Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, pret anëtarët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, priti në Institucionin e Presidentit anëtarët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, me të cilët mbajti një leksion mbi objektivat strategjike të Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s. Gjatë fjalës së tij, Presidenti Begaj vlerësoi Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes si një nga kurset më të mira në piramidën e arsimit ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Duke folur për situatën gjeopolitike, Presidenti Begaj tha ndër të tjera: "Situata gjeopolitike globale është komplekse dhe mendoj që kjo situatë komplekse do të përcaktojë se si do të jetë e ardhmja në dekadat më pas. Ambianti ndërkombëtar i sigurisë dominohet nga sfidat strategjike që janë të ndërthurura me njëra-tjetrën, të cilat kanë sjellë implikime jo vetëm për sigurinë tonë kombëtare, por edhe për atë

ndërkombëtare." Kreu i Shtetit shtoi më tej se arritja e marrëveshjes midis dy vendeve ishte një moment kyç, si dhe ngjarja në Ohër e anekseve ishte një arritje që tregon se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor do të jetë shumë më e mirë. Presidenti Begaj foli dhe për kontributin e Shqipërisë në misionet e ndryshme në botë: "Shqipëria ka qenë kontributore, le të themi eksportuese e sigurisë. Ka qenë..."

»» faqe 2



Ministri Peleshi: Shqipëria, e angazhuar në zbatimin e reformave dhe plotësimin e kriterëve për anëtarësimin në Bashkimin European



»» faqe 3

Ministri Peleshi: Kontributi i Forcës Ajrore i pamatshëm, pjesë e pazëvendësueshme e historisë sonë kombëtare. Krenarë!

Forca Ajrore kremtoi 72-vjetorin e krijimit të saj. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me këtë rast përgëzoi Forcat Ajrore për kontributin e tyre dhënë përgjatë rrugëtimit të vështirë dhe plot sfida, si në drejtimin e infrastrukturës, modernizimit por edhe rritjes së kapaciteteve njerëzore.

Forcat Ajrore janë duke realizuar disa projekte historike. Baza e parë taktike ajrore e NATO-s është tani në ndërtim e sipër dhe ky është një zhvillim historik. "Mbrojtja e hapësirës sonë ajrore, reagimi..."



»» faqe 3

Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan dekoron ekipin shqiptar të kërkim-shpëtimit

Ekipi shqiptar i kërkim-shpëtimit, që ndihmoi në operacionet pas tërmeteve të 6 shkurtit në Turqi, është nderuar me Urdhrin e Lartë Shtetëror për Sakrificën, nga Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan. Kjo medalje është meritë e kontributit të pakursyer të ekipit të kërkim-shpëtimit. Kujtojmë se ekipet shqiptare të kërkim-shpëtimit kanë ndihmuar që të nxirren të gjallë disa trupa nga rrënojat e ndërtesave të shkatërruara nga tërmeti në Turqi...



»» faqe 4

Gjeneral Kingji priti në një takim zyrtar, shefin e Shtabit të FA-ve të Maqedonisë së Veriut, gjenerallejtnant Vasko Gjurchinovski

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim zyrtar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve të Maqedonisë së Veriut, gjenerallejtnant Vasko Gjurchinovski. Takimi mes dy homologëve u fokusua në marrëdhëniet dypalëshe të bashkëpunimit ushtarak, si shtete fqinje dhe si dy vende anëtare në NATO. Gjeneral Kingji u shpreh se: "Vendet tona luajnë një rol kyç në forcimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë në rajon e më gjerë, duke marrë pjesë aktivisht në të gjitha..."



»» faqe 4

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, pret anëtarët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, priti në Institucionin e Presidentit anëtarët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, me të cilët mbajti një leksion mbi objektivat strategjike të Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s.

Gjatë fjalës së tij, Presidenti Begaj vlerësoi Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes si një nga kurset më të mira në piramidën e arsimit ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Duke folur për situatën gjeopolitike, Presidenti Begaj tha ndër të tjera: "Situata gjeopolitike globale është komplekse dhe mendoj që kjo situatë komplekse do të përcaktojë se si do të jetë e ardhmja në dekadat më pas. Ambienti ndërkombëtar i sigurisë dominohet nga sfidat strategjike që janë të ndërthurura me njëra-tjetrën, të cilat kanë sjellë implikime jo vetëm për sigurinë tonë kombëtare, por edhe për atë ndërkombëtare."

Kreu i Shtetit shtoi më tej se arritja e marrëveshjes midis dy vendeve ishte një moment kyç, si dhe ngjarja në Ohër e anekseve ishte një arritje që tregon se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor do të jetë shumë më e mirë.

Presidenti Begaj foli dhe për kon-

tributin e Shqipërisë në misione të ndryshme në botë: "Shqipëria ka qenë kontributore, le të themi eksportuese e sigurisë. Ka qenë pjesëmarrëse në shumë misione ndërkombëtare. Ka qenë në Afganistan, Irak, është në Bosnjë, Letoni, Bullgari dhe Kosovë. Do të jemi

të pranishëm kudo do të na kërkohet dhe është e rëndësishme që të vazhdojmë rrugën tonë për të modernizuar Forcat e Armatosura, jo vetëm me pajisje dhe kapacitete të tjera të nevojshme, por edhe ashtu të mirëtrajtojmë personelin ushtarak."



Kursi i Lartë i Oficerit viziton Komisionin për Sigurinë Kombëtare në vendin tonë

Stafi akademik dhe kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë zhvilluan një vizitë mësimore në Komisionin për Sigurinë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë.

Ata u pritën nga zëvendëskryetari i këtij komisioni z. Xhemal Qefalia, i cili uroi mirëseardhjen dhe më pas i informoi kursantët e kursit mbi punën aktuale dhe detyrat për të ardhmen. Kursantët treguan interes dhe adresuan pyetje mbi çështje të sigurisë.

Kjo vizitë përmbushi qëllimin akademik të programit, duke realizuar njohjen nga afër të aktivitetit të këtij institucioni të rëndësishëm.



Ministri Peleshi: Shqipëria, e angazhuar në zbatimin e reformave dhe plotësimin e kriterëve për anëtarësimin në Bashkimin European

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi priti në një takim zyrtar ministren Federale të Mbrojtjes së Austrisë, znj. Klaudia Tanner. Takimi ishte i një rëndësie të veçantë, pasi të dy ministrat diskutuan bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes dhe rolin e kontributit të veçantë të Austrisë në Ballkanin Perëndimor.

Ministri Peleshi e siguroi ministren Tanner për angazhimin e Shqipërisë në zbatimin e reformave dhe plotësimin e kriterëve për anëtarësimin e vendit tonë në Bashkimin European. Pjesë e diskutimeve ishin gjithashtu ndryshimet e fundit dhe reformat e ndryshme në fushën e Mbrojtjes, investimet dhe modernizimin e Forcave të Armatosura.

Një pikë e rëndësishme e takimit ishte nënshkrimi i Planit të Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes, ku në konferencën e përbashkët ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë tha se: "Nënshkruam ditën e sotme, Planin e Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes për këtë vit, një dokument, i cili shërben si udhërrëfyes mbi bashkëpunimin, koordinimin dhe shkëmbimin e eksperiencës në fushën e emergjencave civile, bashkëpunimit civilo - ushtarak, logjistikës etj."

Ministri Peleshi theksoi gjithashtu rëndësinë që ka mbështetja e Kosovës në aspiratat e saj kundrejt anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, duke kontribuar në forcimin e paqes. Ministri shqiptar i Mbrojtjes u shpreh se: "Miqësisht i kërkoja ministres Tanner, që Ministria e Mbrojtjes së Austrisë, të vijonte kontributin dhe mbështetjen e Ballkanit Perëndimor në kuadër të iniciativave ndërkombëtare dhe rajonale, duke përfshirë këtu



Kosovën, si pjesë e qenësishme e rajonit dhe si një nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor për të qenë kështu gjithëpërfshirës dhe mbi të gjitha gjeopolitikisht korrekt".

Nga ana e saj, ministrja e Mbrojtjes së Austrisë, znj. Klaudia Tanner, falënderoi për mikpritjen ministrit Peleshi dhe shprehu mbështetjen e pakursyer të vendit të saj në rrugën e anëtarësimin të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ministrja Tanner u ndal në rëndësinë e mbështetjes së Ballkanit Perëndimor, sfidat e sigurisë me të cilat përballlet sot Evropa, por edhe globi: "Situata aktuale tregon edhe një herë se mbështetja e miqve tanë të Ballkanit

Perëndimor drejt Bashkimit Evropian është shumë e rëndësishme. Lufta në Ukrainë na mëson të gjithëve se duhet të kujdesemi për stabilitetin pikërisht atje ku është shumë e rëndësishme, pikërisht në rajone ku janë të kërcënuar nga konfliktet dhe rreziqet e jashtme dhe pikërisht në këtë aspekt ne duhet të japim një kontribut të përbashkët për politikën tonë të sigurisë dhe stabilitetit." - u shpreh ministrja e Mbrojtjes së Austrisë.

Të dy ministrat shprehën gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në nivel dypalësh, kryesisht përmes edukimit dhe trajnimit të ushtarakëve.

Ministri Peleshi: Kontributi i Forcës Ajrore i pamatshëm, pjesë e pazëvendësueshme e historisë sonë kombëtare. Krenarë!

Forca Ajrore kremtoi 72-vjetorin e krijimit të saj. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me këtë rast përgëzoi Forcat Ajrore për kontributin e tyre dhënë përgjatë rrugëtimit të vështirë dhe plot sfida, si në drejtimin e infrastrukturës, modernizimit por edhe rritjes së kapaciteteve njerëzore.

Forcat Ajrore janë duke realizuar disa projekte historike. Baza e parë taktike ajrore e NATO-s është tani në ndërtim e sipër dhe ky është një zhvillim historik. "Mbrojtja e hapësirës sonë ajrore, reagimi ndaj situatave emergjente, në kohë të vështira dhe kritike, në fatkeqësi dhe nevojë, në ndihmë e në shpëtim jetësh, përgjatë 72 vitësh, e kanë bërë aviacionin tonë ushtarak dhe pilotët e tij, njerëzit më të dashur dhe të nderuar", - tha Peleshi.

Ministri theksoi se, "kontributi i çdo ushtaraku të Forcës Ajrore është i pamatshëm dhe pjesë e pazëvendësueshme e historisë sonë kombëtare. Krenarë!"



Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan dekoron ekipin shqiptar të kërkim-shpëtimit

Ekipi shqiptar i kërkim-shpëtimit, që ndihmoi në operacionet pas tërmeteve të 6 shkurtit në Turqi, është nderuar me Urdhrin e Lartë Shtetëror për Sakrificën, nga Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan.

Kjo medalje është meritë e kontributit të pakursyer të ekipit të kërkim-shpëtimit.

Kujtojmë se ekipet shqiptare të kërkim-shpëtimit kanë ndihmuar që të nxirren të gjallë disa trupa nga rrënojat e ndërtesave të shkatërruara nga tërmeti në Turqi.

Vlerësim e mirënjohje nga një popull mik, që iu gjend Shqipërisë në ditë të vështira! Të bashkuar për të përballuar çdo fatkeqësi!



Gjeneral Kingji priti në një takim zyrtar, shefin e Shtabit të FA-ve të Maqedonisë së Veriut, gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim zyrtar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve të Maqedonisë së Veriut, gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski.

Takimi mes dy homologëve u fokusua në marrëdhëniet dypalëshe të bashkëpunimit ushtarak, si shtete fqinje dhe si dy vende anëtare në NATO.

Gjeneral Kingji u shpreh se: “Vendet tona luajnë një rol kyç në forcimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë në rajon e më gjerë, duke marrë pjesë aktivisht në të gjitha nismat e NATO-s në mbrojtje të lirisë dhe të vlerave demokratike.

Gjenerallejtënant Gjurchinovski, pasi u njoh mbi procesin e zhvillimit dhe modernizimit të FARSH-së, falënderoi gjeneral Kingjin për pritjen e veçantë, si dhe gjatë takimit dypalësh vuri theksin për angazhimin e përbashkët në gjetjen e mundësive të reja për thellimin e bashkëpunimit mes dy ushtrive të vendeve tona, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Efektivët EOD të KM eliminojnë municionet e paplasura

Efektivët EOD kanë kryer tre operacione të suksesshme në ndihmë të komunitetit për eliminimin e municioneve të paplasura. Këto operacione janë kryer në qytetet e Dibrës, Vlorës dhe Pelqinit. Në masa të larta sigurie është bërë e mundur të transportoheshin predha topi obuz 100mm dhe 122mm nga përroi Lixhave, Peshkopi, Porti i Vlorës dhe fshati Grykësh, bashkia Peqin. Operacionet kanë përfunduar me sukses.



Arsimi, arma më e fortë për të ndryshuar botën



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Për të shkatërruar një komb nuk duhen bomba atomike apo raketa me rreze të largët. Mjafton të ulësh cilësinë e arsimit. Pacientët do të vdesin në duart e mjekëve, ndërtesat e këtyre inxhinierëve do të shemben. Paratë do të shpërdorohen në duart e ekonomistëve dhe llogaritarëve dalë nga sisteme të tilla.

Një komb shkatërrohet kur i shkatërrohet arsimit.

Arsimi ka qenë dhe mbetet drita që na ndriçon në çdo tunel të errët, nëpër të cilin na duhet të kalojmë.

Ndryshmeve historike në shoqëri u paraprijnë elitat udhëheqëse, të cilat herë i kanë përsheptuar proceset integruese dhe herë i kanë ngadalësuar ato. Realitet e dekadave të fundit dëshmojnë ekzistencën e elitës në shoqërinë shqiptare që ushqehet me kulturën europiane dhe luan rolin e pararojës, duke kontribuar në të gjitha fushat, veçanërisht në formimin e një mentaliteti bashkëkohor.

Forcat intelektuale dhe vetë shoqëria përbëjnë fidanishten ku mbillen dhe hedhin shtat idetë progresive. Caqet e mbërritura zhvillimore janë produkt i nivelit të arsimit kombëtar. Ai mbetet starti nga ku marrin udhë teoritë dhe praktikën e nevojshme për ndryshim.

Po cili është mentaliteti dhe vlerësimi i shoqërisë tonë për arsimin dhe problemet e tij?


Shoqëria njerëzore ka dëshmuar një vlerësim të posaçëm ndaj arsimit apo shkollimit, të cilin e ndeshim që në lindjen e qytetërimit evropian. Një nga filozofët më të spikatur të lashtësisë, Platoni, fliste për rëndësinë e edukimit në formimin e shtetit dhe shkruante në hyrjen e Akademisë: "Mos hyni brenda nëse nuk jeni gjeometër."

Arsimi dhe edukimi, janë forma të të mësuarit në të cilat janë transferuar njohuritë, aftësitë dhe zakonet e një grupi njerëzish nga njëri brez në tjetrin, nëpërmjet mësimdhënies, trajnimit apo hulumtimit. Arsimi shpesh zhvillohet nën drejtimin e edukatorëve, mësuesve, pedagogëve, por mund të jetë dhe autodidaktik.

Çdo përvojë që ka një efekt formues në rrugën se si mendohet, ndihet, ose veprohet mund të konsiderohet edukative.

Qëllimi i edukimit mbetet zhvillimi i kapaciteteve individuale të njeriut, që veprimtaria e tij e përditshme të gjejë veten për sa i përket punës që ai zhvillon. Por nëse demokracia mishëron një domethënie ideale dhe morale, kërkohet një bashkëpunim social nga ana e të gjithëve në mënyrë që të gjithë të jenë të aftë të zhvillojnë kapacitetet dhe aftësitë e tyre. Kështu kultura bëhet mjete për të marrë pjesë lirish dhe plotësisht në veprimtari të përbashkëta dhe në këtë kuptim ajo arrin të zhvillojë efikasitetin social. Arritja e dobisë së edukimit social është vlera etike e demokracisë.

Shoqëria ekziston falë procesit të vazhdimësisë nëpërmjet komunikimit Pjesëmarrja në një proces komunikimi do të thotë të modifikosh njohjet,



"Shpresa kryesore e një kombi qendron në edukimin e drejte të të rinjve të tij"

eksperiencat dhe sjelljet e nevojshme gjatë jetës së përditshme. Nëpërmjet hulumtimeve teorike të kombinuara me eksperiencën e fituar mund të krijojmë nivelin tonë kulturor dhe të zhvillojmë më tej fushën e diturisë. Bëhet fjalë për atë lloj kulture që zotëron mjetet e nevojshëm për njohjen e jetës dhe të proceseve përbërëse të saj. Duke përdorur këto lloj mjetesh në mënyrë efikase realizohet edhe një pjesëmarrje aktive në shoqëri. Rezultati i procesit të edukimit është rritja e nivelit kulturor si në rrafshin personal dhe atë kolektiv për t'i venë këto aftësi në shërbim të së ardhmes. Gjatë ekzistencës së tij njeriu u përcjell brezave dijet e trashëguara. Me zgjerimin e njohurive lindi dhe nevoja për të pasur një institucion edukimi dhe dijes, i cila u bë shkolla. Çelësat e këtij edukimi, gjenden në praktikën dhe jetën e përditshme. Këtu gjenden dhe rrënjët e shprehjes "Jeta është një shkollë e vërtetë".

Misioni i filozofisë mbetet ndriçimi i jetës në errësirën e kohës dhe përballimi i konflikteve sociale. Synimi i saj është çmontimi i dhunës dhe ofrimi i zgjidhjeve dhe sundimit të së drejtës dhe të vërtetës. Ndaj, asnjëherë nuk vjetrohët mendimi filozofik i Platonit dhe Aristotelit mbi nevojën e arsimit

dhe edukimit të brezit të ri, përpara daljes së tyre në jetë dhe drejtimin e punëve të shtetit.

Pse është i rëndësishëm arsimimi?

Një person me arsim ndihet më i sigurt se një person i pa arsimuar ose ai që ka vetëm arsim fillor. Edukimi formon një qëndrim pozitiv ndaj jetës, jep vetëbesim dhe ndihmon për të treguar aftësitë e tyre në maksimum, i mëson ata të mbështeten tek vetja në një situatë të caktuar. Edukimi ndihmon përshtatjen sociale, e bën më të lehtë njohjen me njerëz të rinj. Një person i arsimuar është më i shoqëruar, ai ka shumë miq. Duke komunikuar me njerëzit që punojnë në të njëjtën fushë, me kalimin e kohës një person fiton shumë kontakte, rrit sferën e ndikimit të tij dhe formon rreth tij një rreth të njohurish nga të cilët mund të marrin mbështetje në një situatë të vështirë.

Në procesin e edukimit, një person fiton njohuri që e bëjnë personalitetin dhe jetën e tij më interesante dhe kuptimplotë. Një person i arsimuar mund të marrë pjesë në diskutimin e gjërave të rëndësishme, të shprehë mendimin e tij, të cilin të tjerët do ta dëgjojnë. Njerëzit e arsimuar nuk pranojnë thashetheme, u pëlqen të dëgjojnë njerëzit e tjerë, ata

formojnë këndvështrimin e tyre në bazë të fakteve që janë objektive. Sipas shkencëtarëve, njerëzit që kanë një arsim të lartë kanë shumë më pak gjasa të vuajnë nga çrregullime mendore dhe një sëmundje e tillë e rëndë si p.sh. sëmundja e Alzheimerit. Nëse kombinohen aktiviteti mendor me aktivitetin fizik, mund të rritet jetëgjatësia jonë, ky fakt është vërtetuar gjatë studimeve. Dhe jeta do të jetë jo vetëm e gjatë, por edhe interesante, gjë që është e rëndësishme.

Është më e lehtë për një person të arsimuar të kuptojë realitetin përreth. Çdo person përballet me vështirësi të ndryshme në jetën e tij, duke pasur arsimin e duhur është më e lehtë të gresh mundësi për t'i kapërcyer ato. Një person me arsim të mirë i zbaton njohuritë e fituara drejtpërdrejt në praktikë, përdor të gjitha llojet e burimeve të informacionit. Në jetën moderne, arsimi vlerësohet shumë, është një fushë në të cilën ia vlen të investohet.

Një person me arsim të lartë ka më shumë gjasa të marrë një pozicion me pagesë të lartë dhe një punë me perspektivë rritjeje. Nëse përdoren njohuritë e marra në maksimum, pa diskutim që arritjet do jenë të shumta në rrugëtimin tonë.

Roli i dijes në jetën e njeriut është vërtet i paçmuar

Sapo vjen në jetë fëmija, menjëherë fillon të mësojë të njohë njerëzit përreth tij, të mësojë të hajë ushqim vetë, të flasë. Pa njohuri, është e pamundur të ndërtohet një shtëpi, të mësosh t'i trajtosh njerëzit, të drejtosh mirë një makinë, të mësosh për botën që të rrethon, të përshtatesh me kushtet e jetës dhe teknologjisë moderne, asgjë nuk mund të bëhet pa një sasi të caktuar njohurish në veten.

Filozofi anglez Bacon dikur tha: "Dituria është fuqi". Edukimi është para së gjithash, të realizosh veten. Niveli i arsimimit tuaj tregon se sa inteligjent dhe i gjithanshëm jeni në fusha të ndryshme të dijes. Falë edukimit, fitojmë njohuri për aktivitetet e ardhshme, të cilat ofrojnë gjithçka që nevojitet gjatë gjithë jetës.

Shkolla pranon një fëmijë të vogël dhe nxjerr një qytetar të zhvilluar socialisht dhe intelektualisht.

Falë një game të gjerë lëndësh, një i diplomuar në shkollë ka njohuri në fusha të ndryshme shkencore. Kjo e ndihmon atë në marrjen e mëtejshme të një profesioni dhe gjithashtu e karakterizon atë si një person me një pikëpamje të gjerë. Sigurisht, jo të gjitha lëndët do të nevojiten në aktivitetet e ardhshme profesionale, por njohuritë e marra ndihmojnë për të lundruar në jetë, për të analizuar situata komplekse sociale.

Brezi i ri ka nevojë për arsim dhe cilësia e tij duhet të përmirësohet

Dhe kjo është e mundur vetëm kur nxënësit dhe studentët e kuptojnë përgjegjësinë personale për cilësinë e njohurive të tyre. Në fund të fundit, studimi është punë e vështirë, prandaj, kur hyni në një klasë ose një audiencë studentore, gjithmonë duhet ta mbani mend këtë. Shumë të rinj e shohin të mërzitshëm leximin e teksteve shkollore. Fëmijët modernë janë të rrethuar nga pajisje, lojëra, bota virtuale, por kjo nuk u shfaq me magji. Si telefonat celularë ashtu edhe kompjuterët janë krijuar nga njerëz që kanë zotëruar njohuritë shkencore. Prandaj, çdo student duhet të mendojë se çfarë dëshiron të arrijë në këtë jetë dhe kush do të bëhet në të ardhmen. Jeta kërkon gjithnjë e më shumë përditësim të vazhdueshëm të njohurive. Pa etje për dije, është e pamundur një jetë e plotë shpirtërore. Prandaj, ne duhet të kultivojmë një nevojë organike për vetë edukim.

Roli dhe rëndësia e edukimit në jetën e njeriut dhe shoqërisë është shumë i madh dhe nuk duhet neglizhuar. Procesi mësimor është i shumanshëm, mund të jetë i vështirë, por për përpjekjet e tyre, të gjithë marrin shpërblimin e duhur. Nga fëmijëria deri në pleqëri, ne vazhdojmë të mësojmë, shpesh pa e kuptuar vetë. Dhe dija është gjithashtu e rëndësishme sepse pasi ta fitoni atë, atëherë do të jetë e pamundur ta humbni, në ndryshim nga pozita në shoqëri dhe vlerat materiale. Mungesa e edukimit të qytetarëve është një nga problemet kryesore të shoqërisë moderne.

Arsimimi është njohja e vazhdueshme e injorancës sonë, sa më shumë iluminohem i largohemi kësaj sëmundjeje.



Rreziku nga teknologjia, Psikologët: Fëmijët marrin shembull prindërit

Fëmijët përgjithësisht mbyllën nëpër dhomat e tyre me pajisjet e teknologjisë, duke shënuar një fenomen që psikologët e quajnë “Rënie Sociale”.

Prindërit në përgjithësi ankohen se fëmija u qëndron gjithë kohën në telefon, ata nuk kanë interes për t’u angazhuar me aktivitetet familjare, për të ndarë një drekë me familjen, qoftë edhe për të marrë pjesë në ndonjë ditëlindje. Ndoshta, kur kanë edhe njerëz të ftuar, mysafirë në shtëpi, fëmijëve nuk iu pëlqen që të dalin nga dhoma.

Duhet të kemi parasysh që fëmijët modelojnë.

Problemi duhet parë tek shembulli i gabuar që japim. Nëse babai nuk është dakord që fëmija të mos jetë kaq i varur nga mjetet teknologjike, por të jetë më social, më i dashur, të komunikojë, të shprehë ndjenjat e veta, të shpreh emocionet e veta, por kjo gjë nuk ndodh, pasi babai duke i dhënë makinës mban gjithë kohën celularin, nëna duke gatuar flet dhe sheh telefonin, atëherë nuk mund të kemi pretendime.

Sigurisht që gjëja e parë vjen nga vetja.

Nëse familja vendos disa rregulla, se si ata të komunikojnë, se si ata ta ndajnë drekën, kur fëmijët duhet të dalin në natyrë dhe të luajnë. Në atë kohë që prindi është me fëmijën, luan e bisedon me të, gjen bashkëmoshatarë të fëmijës, ka ndërtnuar shumë tek ai fëmijë, qoftë nga ana psikologjike, qoftë nga ana emocionale. Do të harrohen mjetet teknologjike dhe do të ndodhë komunikimi.

Mjerisht, fëmijët e sotëm, shumë më tepër po kalojnë kohën nëpër mjete elektronike se sa në kopshte e foshnjore, sot qetësia në familje sigurohet vetëm përmes këtyre mjeteve! Ai që nuk e ka, do të jetë më i zhurmshmi dhe prishësi i rehatisë në shtëpi! Kthim prapa nuk ka! Ai që do të tentojë ta pengojë këtë proces do të llogaritet si “retrograd”, si “i prapambetur”, “tradicionalist ekstrem”, deri edhe në dhunues familjar, sepse “ia ndrydh dëshirën dhe nevojën” fëmijës për të qenë në hap me moshatarët e vet!

Prindërit, kujdestarët, ata të moshës madhore, duhet të kenë pajisje përcjellëse që do të



sinjalizojnë kur fëmijët do të dalin për navigim më shumë se disa minutat jashtë e platformës.

Natyrisht, lojërat online, që i nënshtrohen procesit edukativo-arsimor, siç janë konkurset, testet, enigmat, fjalëkryqet, mirë plotësimi i të cilëve do të sillte lloj-lloj shpërblimesh,

prej atyre modeste deri te shpërblimet “kapitale”, ndërsa përgjigjet e të cilëve do të gjendeshin brenda tërë atij materiali të gjerë në “platformën nacionale për fëmijë”, do t’i joshin fëmijët tanë që të “mbërthehen” me përqendrim në atë “shkollë të përgjithshme elektronike”, me këtë

rast jo vetëm që do të jenë nën kontroll, por do të jenë të pajisur gjithnjë e më shumë me informacione të shëndosha dhe edukative.

Një prej rubrikave, natyrisht që do të ishte “biblioteka elektronike”, por edhe ndonjë revistë elektronike për fëmijë, siç i kanë të gjithë popujt

e përparuar, pa dyshim! Jemi pothuajse i vetmi komb në rajon e më gjerë që nuk kemi revistë elektronike për fëmijë, që nuk kemi një kolonë lekturash të unifikuar për të gjitha klasat shkollore. Nuk kemi një kënd elektronik ku do të publikoheshin punimet figurative të fëmijëve tanë nga kopshtet gjithandej enteve të viseve etnike. Revista letrare për fëmijët që vijnë në mësimet në ciklin e ulët, por edhe për ata të nëntëvjeçares, do të ishte një hapësirë shumë e frekuentuar në të cilën do të shprehnin interesim të prezantoheshin shumë fëmijë tanë! Në mungesë të një platforme të tillë, në mungesë të një “horizonti elektronik” të tillë, natyrisht që fëmijët tanë do t’i jepen lojërave! Prindërit do të dorëzohen, do të “çmenden” dhe gjithnjë e më të dobët do të tregohen karshi fëmijëve të tyre që humbasin duke naviguar pas “atraktivitetit” nëpër mjetet smart, të cilët tashmë i kanë ushqim, por nga ai që mbledhet nëpër kontejnerë! Institucionet përgjegjëse shtetërore duhet të kujdesen për ushqim të shëndetshëm, me vlera ushqyese e brenda afatit! Neglizhenca i kontribuon “helmimit” të popullatës, sidomos gjeneratës që po rritet, “gjeneratës së teknologjisë elektronike”.



Serenata korçare, magjia e këngës korçare

Originaliteti i serenatës korçare është i padiskutueshëm dhe ka të bëjë me rolin që ajo luajti në botën shpirtërore korçare. Nuk është aspak i çuditshëm apo i dënueshëm ndikimi i serenatës italiane apo qefaloniane në serenatën korçare. Qefalonia është porta nga hyri serenata në Gadishullin Ballkanik. Është meritë e të rinjve korçarë që e përfaquan të parët këtë risi të muzikës së lehtë europiane në vendin tonë. Vangjush Zikos i kanë rënë në dorë tre fletore me tekste serenatash të shkruara prej serenatistit Sotiraq Mite. Në to, autori ka dëshmuar se mjaft prej serenatave janë origjinale në tekst e muzikë, e për disa të tjera pohon me sinqeritet se janë të përkthyer nga tekste të serenatave greke, italiane apo spanjolle. “Këto dëshmi flasin jo vetëm për raportet e serenatës korçare me serenatën mesdhetare, por edhe për sinqeritetin profesional dhe karakterin korrekt të një prej kantautorëve më të përkushtuar, më prodhimtarë dhe më popullorë, i quajtur princ i serenatës korçare, Sotiraq Mite”, - thekson Ziko.

Do të duhej patjetër njëfarë kohe, që kjo përvojë e re e mbartur të “alkimizohet” me shijen dhe me traditën muzikore vendase. Kështu, me krijimin e shoqërive kulturore zyrtare si klubi “Rilindja”, nën drejtimin e profesor Spiro Kondës, shoqëria “Djelmuria korçare”, shoqëria e Arteve të Bukura, e korit “Lyrë” etj., filluan të krijohen e kompozohen shqip edhe këngë dashurie përveç këngëve patriotike. Serenata korçare nisi të marrë tipare origjinale. Kjo krijimtari mori hov veçanërisht në vitet '20 të shekullit të kaluar dhe në vazhdim, kur po njiheshin edhe autorët e këtyre serenatave. Në vitet që pasuan, bëhet fjalë kryesisht për krijime të mirëfillta dhe me plot gojë mund të thuhet se bëhet fjalë tashmë për serenatën origjinale korçare. Originalitetin e saj, serenata korçare, në ndryshim nga kënga lirike, e ka edhe te vendi i interpretimit. Serenata është krijuar për t'u kënduar në rrugë, në skenën natyrore, nën një dritare apo ballkon dhe, detyrimisht kur bie mbrëmja. Këngëtari i serenatës, i mbështjellë nga velloja e natës dhe misteri, është i dashuruari poshtë dritares së të dashurës, e cila ka një emër të përveçëm. Apoteozja e serenatës është lëvizja e lehtë e perdes së dritares, që zëvendëson duartrokitjet dhe drithërimat e sallës. Serenata është shumë më modeste edhe për instrumentet muzikore. Asaj i mjafton një mandolinë apo kitarë. Në fillimet e saj i mjaftonte vetëm fyelli... Pas çastit të ekzekutimit të saj të parë, “premierës” nën dritare, serenata fiton “qytetarinë” e saj për t'u kënduar në rrugë, gosti, në dasma e kudo.

Serenata në shtatë breza

Sipas Vangjush Zikos, serenata korçare, gjatë ekzistencës së saj afro 150-vjeçare, numëron shtatë breza serenatistësh. Grupi i parë u përket viteve 1860-1880, ku merrnin pjesë Gaqo Marko, Spiro Ramizi, Nisi Piasto, Vani Mitko, Thoma Lako, L. Osmanli etj. Një grup tjetër i njohur në kohën e vet përpara vitit 1913 ishte ai i Nodhi Lakos, këngëtar dhe instrumentist, Sotir Dakos, Petraq Pilkatit, Taqi Fundos. Ndërsa kantautori më i njohur i viteve '50 të shekullit të kaluar mbetet Sotiraq Mite. Grupe të tjera të reja të shekullit të kaluar janë “Trëndafil i kuq” me kantautor Sotiraq Qano, Naskë Kondili, Gjergji Peleshi, Naskë Bicollit, Nesti Miska, Aristidh Themeli etj. Viojnë grupe të tjera serenatistësh, si ai i kantautorit Ilia Vinjau, grupi me Ridvan Shëllirën, grupi i kantautorit më në zë aktualisht në Korçë i Mihallaq Andreas, ai i Tomi Kondakçiu, i Nonda Kajnos, i Maksi Kullës, kantautorët e tjerë si Vaskë Gaqi, Ilia Peleshi, Vaskë Nico. Ata që kanë kënduar dhe vazhdojnë ta këndojnë serenatën korçare janë të panumërt në këtë qytet. Në Korçë janë të zakonshme familjet që kanë pasur nga dy apo tre breza serenatistësh. Një nga këto familje të vjetra këngëtarësh është edhe familja Bimbli. Ata këndonin familjarisht me burra dhe gra, zakonisht në oborr apo në shkallët e gurta të shtëpisë së tyre në qendër të qytetit, të lulishtja e “Themistokli Gërmenjit”, që njihet edhe si një nga qendrat burimore më të hershme të serenatës korçare. Të moshuarit tregojnë edhe sot për atë traditë të bukur që kishin në rininë e tyre të largët, për t'u mbledhur e për të kënduar tok në “pare” ose siç u quajtën më vonë edhe shoqëri. Ata mblidheshin për të kënduar dhe për t'u argëtuar, duke ia shtruar me të gjithë të mirat, me sebeb dhe pa sebeb. Këndonin në dasma dhe fejesa, për të kremtuar ditët e emrit. Këndonin në kodrat e qytetit, te kafeneja e Shtetros, tek lokal “Panda” dhe, mbi të gjitha, atje ku e kishte lezetin e saj serenata: nën dritaret dhe ballkonet e vajzave të dashuruara apo bukurosheve korçare të adhuruara. Kjo traditë e bukur e miqësisë dhe gëzimit kolektiv, e sebepeve dhe piknikëve mbeti një traditë e serenatistëve të të gjithë brezave në vite.

Magjia e këngës korçare

Këngët kushtuar Korçës, Vangjush Ziko i quan me plot gojë serenata të vërteta dhe të merituar për këtë qytet që jo më kot, atëherë kur kishte lulëzuar serenata, u quajt edhe “Paris i Vogël”. Me Korçën janë dashuruar dhe i kanë kënduar edhe të huajt që e kanë njohur këtë qytet, pasi kanë zbuluar bukurinë dhe magjinë e serenatës. “Serenatistët e vjetër tregojnë me krenari dhe buzëqeshje se nuk mbahet mend asnjë rast, asnjë incident në sokakët e Korçës të atyre viteve të largëta, që të kenë dalë pleq me dolloma ose plaka me shami në kokë dhe t'i kenë sikterisur apo mallkuar djemtë e serenatave, kur u këndonin bijave apo mbesave të tyre. Vetëm në një rast, kur një bukuri e rrallë korçare dëgjoi se i këndonin poshtë dritares serenatë me pllaka gramafoni, doli dhe hodhi kovën me



ujë mbi kokën e atij që kishte kurdisur veglën muzikore”, na rrëfen dëshmitë e qytetarisë Vangjush Ziko. Dashuria korçare kalonte sokakëve të qytetit me kitarën e hedhur në sup, duke ronitur xixëllimat e telave të saj të argjendta mbi kalldrëm. Grupi i serenatistëve, i veshur si për ditë të kremte, si dhëndurë me ‘shamickën’ e bardhë në xhepin e vogël të xhakëtës, këndonte serenatën më të re. Dashuria korçare këndonte himnin e vet të pavdekshëm - Serenatën! Ridvan Shëllira, një serenatist i vjetër korçar, tregon një histori nga netët e panumërta kur këndonin me kitarë. “I kënduam një bukurosheje nga mëhalla e lumit e na dëgjoi pa e hapur dritaren. Pa e lëvizur perden fare. Ne ishim të sigurt se ajo na dëgjonte, sikur ia ndjenim në sokak frymëmarrjen e saj të shqetësuar. Puna ishte pse nuk na dha ndonjë shenjë, se serenata nuk impononte njeri. Por jo të gjitha vajzat që u këndonim përgjroheshin për ne. Kur po largoheshim nga bukuroshja që nuk na përfilli u hap një portë përkarshi. Del një i moshuar dhe na ftoi brenda se na kishte dëgjuar, por dëshironte akoma të këndonim.

E kush nuk i ka ndier me shpirt serenatat! Kemi kënduar serenata edhe në vdekje, sepse serenata edhe pikëllimin e vdekjes e vë poshtë”. Për magjinë e serenatës tregojnë edhe një ndodhi tjetër. Familja e vjetër tregtare e Kaçadanëve në Korçë kishte përjetuar shumë fatkeqësi radhazi. Dera e kësaj shtëpie qëndronte vazhdimisht e mbyllur, i kishte pllakosur zija. Pareja e serenatistëve shkoi një mbrëmje dhe trokiti në portën e tyre. E hapi plaku i shtëpisë, por kur pa grupin e djemve me kitara dhe mandolinë u mbylli derën me nervozizëm. Ndërkohë, një nga djemtë kishte arritur të vinte këmbën dhe e kishte penguar derën të mbyllë plotësisht. Të rinjtë këmbëngulën të hyjnë brenda, duke i thënë plakut se kishin ardhur t'i jepnin asaj shtëpie çaste të gëzuara dhe ta prishnin atë zi që i rëndonte jo vetëm familjes, por edhe mëhallës dhe tërë qytetit. Plaku i lejoi më në fund të hyjnë serenatat që u kënduan me gjithë shpirt e sfiduan vdekjen e zinjë që kishte pllakosur shtëpinë e Kaçadanëve, e cila kishte djem e vajza të tjera për të martuar. Serenata ka lidhur me martesë edhe djem e vajza, pasi prindërit nuk pranonin në fillim dashurinë e tyre për shkaqe sociale, sepse ajo nuk ishte vetëm këngë e qejfeve, e mallit përvëlues dashuror, por edhe emancipimit dhe gëzimit të jetës.

Femrat serenatiste

Emancipimi që solli serenata në jetën e qytetit përfshiu edhe femrat korçare, të cilat nuk qëndruan vetëm duke i dëgjuar këngët e dashurisë pas perdes së dritares, por i krijuan dhe kënduan edhe vetë ato. “Serenata është një qelq, ku brenda saj rreh një zemër e kristaltë”, ka thënë e para serenatiste korçare, Spanja Pipa. Spanja, që ishte me fat, sepse vinte nga një familje që e dashuronte muzikën, ishte nga të parat vajza që u ngjit në skenë dhe këndoi serenata para publikut korçar. Repertori i serenatave të saj nuk është i madh, por as i vogël. Ka të regjistruar në diskun e saj dhjetë këngët më të dashura për të, këngë që i kushtohen mallit të dashurisë. “Serenatat i këndojnë hapur dhe sinqerisht dashurisë. Shumë dhimbje që këndojnë serenatat janë dhimbje të asaj kohe, kur dashuria duhej të mbahej e fshehtë”, thotë Spanja Pipa. Ajo kujton bashkëpunimet me Aleko Skalin e Pirro Manin, kur flisnin për serenatën korçare dhe shpreheshin se gurët e rrugëve të Korçës ruajnë shumë kujtime, por edhe shumë të puthura. Vajzat korçare

i kanë kënduar serenatat në mjediset e shtëpisë apo edhe në dasma për qejfet e tyre. Gjithashtu i kanë krijuar brenda mureve të shtëpisë dhe po atje i kanë kënduar dhe dashje pa dashje janë bërë pronë e grupeve të serenatistëve të qytetit.

Vasilika Bimbli, sot në moshë të thyer, ka krijuar para më shumë se gjysmë shekulli serenatën e titulluar “Sikur ta dinte zemra jote”. Një tjetër pinjolle e kësaj familjeje, Jorgjeta Lalazi, këndon edhe sot në skenën korçare me zërin e saj të ëmbël e pasionant serenatat. “Korçarët e brezit tim nuk e harrojnë këngëtarin e talentuar Pavlina Nika, e cila është e para që ka kënduar përveç serenatave korçare, edhe serenatat spanjolle në skenë”, shkruan Vangjush Ziko. Këngëtare të tjera të serenatës dhe që vazhdojnë ta interpretojnë akoma janë edhe Eli Fara, Lazarella Deti, Mimoza Paraveli, Ermira Kola. Nuk mund të lihet pa përmendur Ermira Babaliu, aktualisht në emigrim në SHBA. Ajo jo vetëm e ka kënduar me shumë pasion serenatën, por është pikërisht kjo këngëtare, e cila në dekadat e fundit të shekullit të kaluar, kur “bilbilat” e serenatës u detyruan të heshtnin, të këndonin nëpër rrugë, që i mbajti të freskëta serenatat me koncertet e saj.

Bilbilat e serenatës heshtin...

Kantautorët dhe serenatistët e brezit të viteve '60-'70, veçanërisht ata të brezit të gjashtë, tregojnë peripeci sa qesharake edhe të trishtuara. Serenata që kishte qenë për dekada me radhë një stoli e mbrëmjeve korçare, një sonatë hënore, shpallej e ndaluar, se prishte gjumin e qytetarëve, të vajzave që nuk duheshin “shqetësuar”, sepse shumë prej tyre punonin në turnet e natës. Serenatat nëpër rrugë dhe oborre ishin bërë të padëshuruara për pushtetin e ri. Bilbilat e serenatës dalëngadalë heshtën, nuk u dëgjuan nëpër rrugët e Korçës këngët e tyre. Serenatat këndoheshin vetëm në mjediset e mbyllura. Serenatistët e atyre viteve kujtojnë se ata që guxonin të dilnin me kitarë rrugës, i merrnin dhe i mbyllnin për një natë në polici. Për peripecitë e tij si këngëtar i serenatave ka treguar edhe kantautori Mihallaq Andrea. Atij nuk iu dha e drejta për të vazhduar studimet e larta dhe punoi në një gurorë. Veten e ka në personazh të një romani, dhe shprehet se në atë kohë ecte si një xhenaze dhe qante. Po çfarë kishte bërë? Vetëm kishte kënduar. Serenatistin Tomi Kondakçi e arrestuan dhe e burgosën, duke ia ndërprerë për tetë vjet pasionin e tij për serenatën, por pa mundur t'ia shuajnë këtë pasion. E vërteta ishte se serenatat i pëlqenin shumë udhëheqës dhe militantë të partisë, sidomos korçarë, por ato i këndonin në rrethe të ngushta. Ky qëndrim i egër e përshpejtoi venitjen e parakohshme të serenatës në Korçë. Tani, në një periudhë që Vangjush Ziko e quan “Post-serenata”, kjo gjini muzikore nuk mund të krijohet më si dikur, me gjithë dëshirën e mirë dhe nostalgjinë që kemi për të. Ajo e mbylli ciklin e vet dhe atë mision historik të emancipimit shpirtëror, intim e shoqëror, që pati në vitet e kaluara. Megjithatë, kantautorët e serenatës korçare bëjnë përpjekjet e tyre për rinovimin e saj, duke qenë në kërkim të atij kufiri që do ta mbante formalisht serenatën brenda kërkesave të gjinisë së saj. Por, shkëputja e serenatës nga sfondi i saj tipik, nga “skena” e rrugës po e shpie drejt gjinisë tjetër, këngës lirike që ngjitet në skenë dhe jo nën dritaren apo ballkonin e vajzës. Serenatës tani i mungon ritmi i trokitjeve të një zemre, që rreh e lumtur pas perdes së dritares, duke e ndier veten një perëndeshë, së cilës i kanë rënë në gjunjë dhe i betohen për adhurim të përgjithshëm.

Forcat Speciale më mbresëlënëse në botë

Shumë kombe kanë ekupe të forcave speciale të përbëra nga ushtarë shumë të trajnuar, të cilëve u janë besuar detyrat më sfiduese ushtarake. Këto njësi u shfaqën për herë të parë në shekullin e 20-të dhe u bënë më të përhapura gjatë Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht kur secila ushtri pjesëmarrëse në luftë vendosi operacionet e saj speciale. Anëtarët e këtyre forcave duhet t'i nënshtrohen një procesi trajnimi rigoroz, me vetëm një përqindje të vogël të rekrutëve më të ashpër që bëjnë prerjen përfundimtare. Këtu janë disa nga forcat speciale më mbresëlënëse në mbarë botën:



SAS BRITANIKE

I themeluar në vitin 1950, Shërbimi Special Ajror (SAS) i Ushtrisë Britanike është një njësi e dalluar e forcave speciale që specializohet në një sërë operacionesh, duke përfshirë kundër-terrorizmin, shpëtimin e pengjeve dhe zbulimin e fshehtë. Procesi i përzgjedhjes është shumë konkurrues, me një shkallë suksesi prej vetëm 15% deri në 20%. Në përgjithësi, nga 200 aplikantë, më pak se 30 individë do të zgjidhen për t'u nënshtroar trajnimit.

'SHAYETET 13' E IZRAELIT

'Shayetet 13' është një njësi shumë e respektuar brenda Marinës izraelite dhe luan një rol vendimtar si forca kryesore e zbulimit për Forcat e Mbrojtjes të Izraelit. Kompetencat e tij kryesore përfshijnë kryerjen e operacioneve det-tokë, kryerjen e misioneve sabotuese, mbledhjen e inteligjencës detare, reagimin ndaj kërcënimeve terroriste dhe kryerjen e shpëtimin të pengjeve në mjediset detare. Anëtarët aspirantë të 'Shayetet 13' angazhohen të shërbejnë për katër vjet e gjysmë, që është një vit e gjysmë më e gjatë se periudha e detyrueshme trevjeçare e rekrutimit që u kërkohet të plotësojnë burrat izraelitë.



GRUPI I SHËRBIMIT SPECIAL I PAKISTANIT

Beretat kafe, të njohura gjithashtu si Grupi i Shërbimit Special i Ushtrisë së Pakistanit ose SSG, specializohen në një sërë operacionesh ushtarake, duke përfshirë zbulimin, veprimin e drejtpërdrejtë, kundër-terrorizmin, luftën jokonvencionale dhe mbrojtjen e brendshme të huaj.



JAGDKOMMANDO AUSTRIAKE

Jagdkommando, dega e forcave speciale të ushtrisë austriake, ka fokusin kryesor në luftën kundër kryengritjeve dhe terrorizmit. Emri i saj vjen nga Lufta e Parë Botërore, kur Ushtria Austriake K.u.K iu referua grupeve të vogla si "komando të gjuetisë njerëzore".



FORCAT E ARMATOSURA TË TAJVANIT

Forcat e Armatosura të Republikës së Kinës, të njohura gjithashtu si Forcat e Armatosura të Tajvanit, përfshijnë disa degë, duke përfshirë Ushtrinë, Marinën, Forcën Ajrore dhe Forcën e Policisë Ushtarake. Në vitet 1970, një nga objektivat kryesore të forcave ishte të rimarrë Kinën kontinentale nga Republika Popullore komuniste e Kinës, të cilën ata synonin ta arrinin përmes Projektit Kombëtar Glory.



POLICIA KOMBËTARE E PERUSË

Policia Kombëtare e Perusë është një organizatë që vepron së bashku me Forcat e Armatosura Peruane, por me një fokus të veçantë në përpjekjet kundër terrorizmit. Anëtarët e saj zotërojnë cilësi të ngjashme me ushtrinë, duke bërë që disa ta konsiderojnë atë de facto një shërbim të katërt ushtarak. Forca krenohet me një anëtarësim prej rreth 140 000 individësh dhe ka aftësi në të gjithë domenet tokësore, detare dhe ajrore.



'JOINT TASK FORCE 2' KANADEZE

'Joint Task Force 2' (JTF2) është një forcë kryesore e operacioneve speciale në Forcat e Armatosura Kanadeze, që vepron në kuadër të Komandës së Forcave të Operacioneve Speciale Kanadeze. Dihet se bashkëpunon me njësi të tjera elitare si Forcat e Marinës së SHBA-së, Delta Force dhe British SAS. Për shkak të operacioneve të fshehta dhe nivelit të lartë të fshehtësisë, JTF2 konsiderohet si një njësi e operacioneve speciale të klasit botëror.



DELTA FORCA E SHBA-SË

Delta Forca, e njohur zyrtarisht si Detashmenti i Parë Operacional i Forcave Speciale, është një njësi operacionesh speciale brenda Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara që është kryesisht përgjegjëse për misionet kundër terrorizmit, shpëtimin e pengjeve dhe veprimet e drejtpërdrejta. Ata janë shumë të trajnuar dhe të aftë në zbulimin special dhe shpesh punojnë kundër objektivave me vlerë të lartë. Shumica e anëtarëve të Delta Forcës janë rekrutuar nga Komanda e Operacioneve Speciale të Ushtrisë Amerikane, Regjimenti i 75-të 'Ranger' dhe Forcat Speciale.



KORPUSI DANEZ I GJUEJARËVE

Korpusi Danez 'Jaeger', i njohur gjithashtu si Korpusi i Huntsmen, është një njësi e operacioneve speciale të Mbrojtjes Daneze dhe pjesë e Komandës së Operacioneve Speciale. Ajo ka një histori të gjatë që nga viti 1785, kur Danimarka po përballlej me kërcënime nga fuqi të ndryshme evropiane. Sot, Korpusi 'Jaeger' është përgjegjës për kryerjen e një sërë operacionesh të specializuara, të tilla si zbulimi, veprimi i drejtpërdrejtë, kundër-terrorizmi dhe shpëtimi i pengjeve.



FORCAT E OPERACIONEVE SPECIALE TË IRAKUT

Me rrënjët e saj që datojnë që nga viti 1950, Forcat e Operacioneve Speciale të Irakut janë një njësi e specializuar e



udhëhequr nga Shërbimi Kundër Terrorizmit irakian. E përbërë nga tre brigada të Komandës Kundër Terrorizmit, njësia financohet nga Ministria e Mbrojtjes.

SNAJPERËT E FORCAVE SPECIALE TË USHTRISË AMERIKANE

Të konsideruar si disa nga anëtarët më të aftë të komunitetit të operacioneve speciale, snajperët brenda Forcave Speciale të Ushtrisë Amerikane kanë aftësi të jashtëzakonshme që mund të jenë mjaft frikësuese. Portretizimi i Bradley Cooper i Chris Kyle në filmin 'American Sniper' dha një pasqyrë të jetës së një snajperi. Për të siguruar përshtatshmërinë e tyre ndaj mjedisëve të ndryshme, snajperët i nënshtrohen kurseve intensive të gjuhës dhe kulturës.



KOMANDOT E MARINËS FRANCEZE

Si Forcat Speciale të Operacionit të Marinës Franceze, Komandot e Marinës, të njohur gjithashtu si Beretat e Gjelbra, mbajnë një pozicion të vlerësuar brenda Komandës së Pushkatarëve Detar dhe Forcave të Operacioneve Speciale (FORFUSCO) dhe janë një komponent kyç i Komandës së Operacioneve Speciale Franceze. Kjo njësi e shquar e ka origjinën e saj në vitin 1942, gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe që atëherë ka fituar një reputacion të jashtëzakonshëm.



'SPETSNAZ' RUSE

Forcat e Operacioneve Speciale Ruse, të njohura si Spetsnaz, përfshijnë një shumëllojshmëri të njëjve ushtarake shumë të aftë. Midis tyre është 'Spetsnaz GRU', e cila shërben si shërbimi kryesor i inteligjencës dhe tërheq personelin e saj nga Forcat Tokësore, Forcat Ajrore, Marina, Marinsat, Garda Kombëtare dhe njësi të tjera elitare.



'Bisfenoli A' në ushqim është një rrezik për shëndetin

Ekspozimi dietik ndaj bisfenolit A (BPA) është një shqetësim shëndetësor për konsumatorët në të gjitha grup-moshat, në këtë përfundim kanë arritur ekspertët shkencorë të EFSA në një rivlerësim të ri.

Në një vlerësim të gjerë të provave shkencore dhe pas të dhënave nga një konsultim publik, ekspertët e EFSA identifikuan efekte të dëmshme shëndetësore në sistemin imunitar.

Komisioni Evropian dhe autoritetet kombëtare do të diskutojnë masat e duhura rregulatore për të ndjekur këshillën e EFSA-së.

BPA është një substancë kimike e përdorur në kombinim me kimikate të tjera për të prodhuar plastika dhe rrëshira të caktuara.

BPA përdoret për shembull në plastikë polikarbonate, një lloj plastik transparent dhe i ngurtë që përdoret për të bërë shpërndarës uji, kontejnerë për ruajtjen e ushqimit dhe shishe pijesh të ripërdorshme. Substanca përdoret gjithashtu për të prodhuar rrëshira epokside që gjenden në veshjet dhe veshjet mbrojtëse për kanaçet dhe kazanët e ushqimit dhe pijeve.

Kimikatet si BPA që përdoren në kontejnerët e produkteve ushqimore mund të migrojnë në sasi shumë të vogla drejt ushqimit dhe pijeve që ato përmbajnë, kështu që shkencëtarët e EFSA-së rishikojnë rregullisht sigurinë e tyre, duke marrë parasysh të dhënat e reja.

Të dhëna të gjera

Dr. Claude Lambré, Kryetar i Panelit të EFSA-së për Materialet, Enzimën dhe Ndihmat e Përpunimit të Kontaktit me Ushqimin, tha: "Shkencëtarët tanë kanë ekzaminuar sigurinë e BPA-së në detaje gjatë viteve, që nga vlerësimi ynë i parë i plotë i rrezikut të substancës në 2006.

Për këtë rivlerësim, ne shqyrtuam një sasi të madhe botimesh shkencore, duke përfshirë mbi 800 studime të reja të botuara që nga janari 2013. Kjo na ka lejuar të adresojmë pasiguri të rëndësishme në lidhje me toksicitetin e BPA-së.

Në studimet, ne kemi vërejtur një rritje të përqindjes së një lloji të qelizave të bardha të gjakut, të quajtur 'T helper', në shpretkë. Ato luajnë një rol kyç në mekanizmat tanë imunitar qelizor dhe një rritje e këtij lloji mund të çojë në zhvillimin e inflamacionit alergjik të mushkërive dhe çrregullimeve autoimune", - tha ai.

Paneli gjithashtu mori parasysh efektet e tjera potencialisht të dëmshme shëndetësore në sistemet riprodhuese, zhvillimore dhe metabolike që u identifikuan në vlerësimin e rrezikut.

Qasje sistematike

Dr. Henk Van Loveren, kryetar i grupit të punës të EFSA-së për



rivlerësimin e BPA, tha: "Për të vlerësuar numrin e madh të studimeve të publikuara që nga viti 2013 - pika kufitare për vlerësimin tonë të mëparshëm në 2015 - ne aplikuam një sistem sistematik dhe qasje transparente. Ne zhvilluam paraprakisht një protokoll për përzgjedhjen dhe vlerësimin e të gjitha provave me kontributin e

palëve të interesuara dhe autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare.

"Gjetjet tona janë rezultat i një procesi vlerësimi intensiv që ka zgjatur disa vite dhe të cilin e kemi finalizuar, duke përdorur të dhënat që kemi mbledhur nga një konsultim publik dymujor i nisur në dhjetor 2021", - shtoi ai.

Krahasuar me vlerësimin e tyre të mëparshëm në vitin 2015, Paneli i ekspertëve të EFSA-s uli ndjeshëm dozën ditore të tolerueshme (TDI) për BPA, sasia që mund të gëlltitet çdo ditë gjatë gjithë jetës pa paraqitur një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin.

Në vitin 2015, ekspertët vendosën një TDI të përkohshme për shkak të

paqartësive në prova, duke theksuar nevojën për të dhëna shtesë mbi efektet toksikologjike të BPA-së.

Ky rivlerësim i ri adresoi shumicën e këtyre boshllëqeve dhe pasiguritë e mbetura u morën parasysh gjatë përcaktimit të TDI.

Shkencëtarët e EFSA vendosën një TDI prej 0.2 nanogramësh (0.2 miliarda të gramit) për kilogram të peshës trupore në ditë, duke zëvendësuar nivelin e mëparshëm të përkohshëm prej 4 mikrogramësh (4 milion të gramit) për kilogram të peshës trupore në ditë.

TDI i sapokrijuar është rreth 20 000 herë më i ulët.

Ekspozimi ndaj BPA

Duke krahasuar TDI-në e re me vlerësimet e ekspozimit dietik ndaj BPA, ekspertët tanë arritën në përfundimin se konsumatorët me ekspozim mesatar dhe të lartë ndaj BPA në të gjitha grupmoshat e tejkaluan TDI-në e re, duke treguar shqetësime shëndetësore.

Megjithëse Paneli ynë i ekspertëve përdori vlerësimet e ekspozimit nga vlerësimi i tyre në vitin 2015, ne pranojmë se kufizimet e vendosura nga ligjvënësit e BE-së pas vitit 2015 për disa përdorime të substancës mund të kenë reduktuar marrjen e ushqimit. Kjo do të thotë se skenari ynë është konservator.

Disa variabla mund të ndikojnë në rrezikun e përgjithshëm shëndetësor për një individ, duke përfshirë faktorë të tjerë stresues në trupin e njeriut, gjenetikë dhe ushqim.



JAVA EVROPIANE E IMUNIZIMIT 2023

Këtë vit, Java Evropiane e Imunizimit, e shënuar midis 23 dhe 29 prillit, na kujton rëndësinë e vaksinimit rutinë në kohë dhe pse duhet të kapim çdo vaksinë dhe doza shtesë të humbura ose të shtyra.

Disa vaksina rutinë janë të disponueshme për të gjitha grupmoshat – fëmijët e vegjël, adoleshentët, të rriturit dhe të moshuarit – për të na mbrojtur nga sëmundjet e rrezikshme si fruthi, rubeola, hepatiti ose meningjiti, vetëm për të përmendur disa. Ndërprerjet e shkaktuara nga COVID-19 në kujdesin shëndetësor dhe në jetën tonë personale kanë çuar në vonesa serioze në marrjen e vaksinave rutinë, duke shkaktuar pasoja të rëndësishme në komunitetet tona në të gjithë Bashkimin Evropian (BE). Le të marrim shembullin e fruthit. Dy dekada më parë ky virus ishte një vrasës i madh i fëmijëve. Fruthi është gjashtë herë më infektues se gripi dhe një në pesë persona mund të zhvillojë sëmundje të rënda ose komplikime. Ndërmjet viteve 2000 dhe 2018, vdekjet nga fruthi ranë me tre të katërtat (73%) në mbarë botën, me vaksinat që parandaluan rreth 23.2 milionë vdekje gjatë kësaj periudhe. Pavarësisht përfitimeve të dukshme të mbrojtjes kundër fruthit dhe sëmundjeve të tjera të fëmijërisë, mbi 1.2 milionë fëmijë në Rajonin Evropian të OBSH-së kanë humbur një vaksinim për t'i mbrojtur ata kundër fruthit, shtave dhe rubeolës që nga fillimi i pandemisë COVID-19. Për më tepër, një raport i UNICEF-it i botuar së fundmi tregon se 67 milionë fëmijë në mbarë botën "humbën nga një ose më shumë vaksina gjatë tre viteve për shkak të ndërprerjes së shërbimit të shkaktuar nga sistemet e tendosura shëndetësore dhe devijimi i burimeve të pakta, konflikti dhe brishtësia dhe ulja e besimit" të imunizimit. Java Evropiane e Imunizimit duhet të jetë një thirrje për veprim për çdo qytetar evropian. Ne nuk mund të qëndrojmë pasivë përballë kërcënimeve si fruthi, poliomieliti, difteria apo tetanusit.

Nuk duhet të dështojmë të vazhdojmë me imunizimin kundër rubeolës. Gratë shtatzëna të pa vaksinuara që sëmuren nga rubeola janë në rrezik të lartë të abortit ose sindromës kongjenitale të rubeolës tek foshnjat e tyre.

Nuk mund të mbetemi prapa në vaksinimin e adoleshentëve dhe fëmijëve të moshës 9-14 vjeç kundër papillomavirusit human (HPV). Infeksioni me këtë virus tek djemtë dhe vajzat mund të çojë në disa kancere më vonë në jetë, kur ata janë gra dhe burra të rritur. Së fundi, ne duhet të mbrojmë të moshuarit. Ata janë në rrezik të lartë të shtrimit në spital ose vdekjes kur kapin një virus.

Vaksinimi në kohë është thelbësor

Dua t'i kujtoj të gjithëve se vaksinat janë përdorur për dekada në miliona njerëz. BE ka rregulla shumë strikte për autorizimin e vaksinave, për të mbrojtur ju dhe familjen tuaj. Pasi vaksinat janë në përdorim, Agjencia Evropiane e Barnave po monitoron vazhdimisht sigurinë e tyre, kështu që çdo efekt negativ mund të zbulohet, hetohet dhe menaxhohet menjëherë. Të kuptuarit se si funksionojnë vaksinat mund të shpëtojë jetën tuaj ose jetën e dikujt që doni. Ju inkurajoj, pavarësisht nga moshë dhe vendndodhja juaj, të filloni një bisedë me mjekun, farmacistin ose infermieren tuaj rreth imunizimit. Shikoni orarin e vaksinimit për grupmoshën tuaj, por edhe për prindërit tuaj dhe për fëmijët tuaj. Shkruani pyetjet tuaja dhe diskutoni ato me profesionistët e kujdesit shëndetësor; ata do të jenë në gjendje t'ju japin udhëzimet që ju nevojiten.

Drejtori Ekzekutiv Emer Cooke: Vaksinimi rutinë ka rëndësi! Çdo dozë ka rëndësi për të qëndruar i mbrojtur



Këshilli dhe Parlamenti Evropian bien dakord për dekarbonizimin e sektorit të aviacionit

Këshilli dhe Parlamenti Evropian arritën një marrëveshje të përkohshme politike mbi një propozim që synon të dekarbonizojë sektorin e aviacionit dhe të krijojë një fushë loje të barabartë për një transport ajror të qëndrueshëm (iniciativa e aviacionit ReFuelEU).

Propozimi synon të rrisë kërkesën dhe ofertën e karburanteve të qëndrueshme të aviacionit (SAF), duke siguruar një fushë loje të barabartë në të gjithë tregun e transportit ajror të BE-së. Është një propozim i madh që synon të vendosë transportin ajror në trajektoren e objektivave klimatike të BE-së për 2030 dhe 2050, pasi SAF janë një nga mjetet kryesore afatshkurtër dhe afatmesëm për dekarbonizimin e aviacionit. Ajo duhet të sigurojë një rrugëdalje nga situata që po pengon zhvillimin e tyre: ofertë e ulët dhe çmime që janë ende shumë më të larta se karburantet fosile.


Aspektet kryesore të propozimit të Komisionit

Teksti i marrëveshjes së përkohshme ruan aspektet thelbësore të propozimit të Komisionit, duke përfshirë masën në të cilën ajo kontribuon në përmbushjen e objektivave të klimës. Elementet kryesore të marrëveshjes përfshijnë:

- Detyrimi për furnizuesit e karburanteve të aviacionit për të siguruar që e gjithë karburanti i vënë në dispozicion të operatorëve të avionëve në aeroportet e BE-së të përmbajë një pjesë minimale të SAF nga viti 2025 dhe, nga viti 2030, një pjesë minimale të karburanteve sintetike, me të dyja pjesët që rriten në mënyrë progresive deri në vitin 2050.

- Krijimi i një periudhe kalimtare, që lejon furnizuesit e karburanteve të arrijnë mandatin e përzjerjes SAF si një mesatare e ponderuar e sasive që ata kanë furnizuar në të gjithë Bashkimin, në mënyrë që të lehtësohet organizimi i sektorit gjatë fazës së krijimit të tij, pa ndikuar në nivelin e përgjithshëm të emetimeve.

- Detyrimi për operatorët e avionëve për të siguruar që sasia vjetore e karburantit të aviacionit të ngritur në një aeroport të caktuar të BE-së është të paktën 90% e karburantit vjetor të kërkuar të aviacionit, për të shmangur emetimet që lidhen me peshën shtesë të shkaktuar nga praktikat e transportit me cisterna.



- Detyrimet raportuese për furnizuesit e karburanteve dhe operatorët e avionëve.

- Rregullat për autoritetet kompetente, që do të caktohen nga shtetet anëtare për të zbatuar këtë rregullore, dhe rregullat për gjokat.

Ndryshimet kryesore në propozimin e Komisionit

Teksti i marrëveshjes së përkohshme ndryshon, megjithatë, disa aspekte të propozimit të Komisionit, me synimin për të lehtësuar dhe përshpejtuar zhvillimin e SAF, në veçanti:

Zgjerimi i fushëveprimit në lidhje me aeroportet e Unionit dhe operatorët e avionëve. Zgjerimi i fushës së karburanteve të pranueshme të qëndrueshme të aviacionit dhe karburanteve sintetike të aviacionit. Për biokarburantet, objekti shtrihet në biokarburantet e tjera të certifikuar që

përputhen me kriteret e qëndrueshmërisë dhe kursimit të emetimeve të Direktivës së Energjisë së Rinovueshme (RED), deri në një maksimum prej 70%, me përjashtim të biokarburanteve nga kulturat ushqimore dhe shtimin e dy lëndëve djegëse (hidrogjen dhe lëndë djegëse sintetike të aviacionit me karbon të ulët), të cilat mund të përdoren për të arritur përqindjet minimale në pjesën përkatëse të rregullores. Futja e mundësisë për autoritetet kompetente të shteteve anëtare për të dhënë një përjashtim nga dispozitat e transportit me cisternë për disa fluturime në rast të vështirësive operacionale serioze dhe të përsëritura ose vështirësive strukturore në furnizimin me karburant në përputhje me kriteret e identifikuar.

Promovimi i hidrogjenit në aeroportet e Unionit.

Krijimi i një skeme etiketimi të Unionit për performancën mjedisore për operatorët e avionëve që përdorin SAF do të ndihmojë konsumatorët të bëjnë zgjedhje të informuara dhe do të promovojë fluturime më të gjelbra.

Mbledhja e të dhënave dhe detyrimet e raportimit janë përforcuar për të monitoruar efektet e kësaj rregulloreje në konkurrencën e operatorëve dhe platformave të BE-së dhe për të përmirësuar njohuritë për efektet jo-CO2 të emetimeve të transportit ajror.

Konsiderata të reja që Komisioni pritet të përfshijë në raportin e tij në vitin 2027, si ndikimi i kësaj rregulloreje në lidhje, në rrjedhjet e karbonit dhe shtrembërimet e konkurrencës dhe në përdorimin e ardhshëm të hidrogjenit dhe energjisë elektrike.

Karriera brilante e 'skenderbegasit' Zaim Kuçi

Zaim Kuçi, është ndër skënderbegasit me një karrierë brilante si ushtarak madhor e diplomat, duke fituar njëkohësisht mirënjohje të larta zyrtare, përfshi medaljen "Oficer i Urdhrit Kombëtar të Meritës", dhënë nga Presidenti i Republikës Franceze; "Qytetar Nderi i Beratit" etj...

Kolonel Zaim Kuçi ka kryer shkollën tetëvjeçare ("24 Maj"), në qytetin e tij të lindjes, në periudhën nga viti 1967 deri në vitin 1970, të cilën e ka mbaruar me rezultate shumë të mira.

Ai ka kryer shkollën 'Skënderbej' në Tiranë, Shkollën e Lartë të Aviacionit Vlorë dhe është titulluar Pilot Gjuajtës Bombardues. Ka bërë më shumë se 14 vite fluturimi në detyrën e Komandantit të Ekuipazhit në avionët helikë/reaktivë Jak 18, Mig-15, Mig-17 dhe në avionin supersonik Mig-19 në Bazat Ajrore: Vlorë, Kuçovë, Gjadër dhe Rinas.

Ka kryer studime të larta ushtarake dhe detyra të rëndësishme si: Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë, Kolegjin Gjitharmësh të Mbrojtjes në Paris, Studime Aeronautike, Institutit Francez i Sigurisë Ajrore në Paris dhe Akademia Diplomatike Shqiptare, Tiranë. Ka mbajtur disa detyra të rëndësishme në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në Ministrinë e Mbrojtjes. Shef i Stërviçes të Forcave Ajrore, Tiranë, Shefi i Shtabit të Bazës Ajrore, Kuçovë, Zëvendëskomandant i Akademisë të Forcave Ajrore, Vlorë, Pedagog në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë, Shef Sektori i Strategjisë në Shtabin e Përgjithshëm, Tiranë, Këshilltar i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Analist/Koordinator në Qendrën Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Zaimi ka kryer disa kurse afatshkurtra Doktrinë/Strategji, SHBA, Holandë, Hungari, Gjermani, Kroaci. Bazuar në eksperiencën e fituar në vite dhe formimin e tij jashtë vendit, ai u përzgjedh si Atashe i parë i Mbrojtjes për të hapur misionin ushtarak pranë Ambasadave të RSH-së në Francë dhe në Portugali, ku punoi si diplomat nga gushti 2006 deri në dhjetor 2010.

Për gjatë 44 viteve pune në uniformë, të realizuar në diversitet dhe gjeografi detyrash dhe shtetesh, ai i ka përmbushur me dinjitet, duke prezantuar një personalitet ushtarak, modelin e shkëlqyer të vendit dhe forcave tona të armatosura. Zaimi ka dhe një Kontribut të gjerë mediatic. Ka botuar në shtypin vendas, francez dhe të Bashkimit Europian (revista Defense) më shumë se 50 artikuj, duke trajtuar analiza për çështje të sigurisë, mbrojtjes, si dhe opinione në interes të shoqërisë. Zaimi ka lindur në Drobonik të Beratit, më 17 maj të vitit 1955, është baba i dy vajzave dhe banon në Tiranë.

Emocionet, sakrificat dhe përkushtimin e tij në rrugëtimin e gjatë nën uniformën ushtarake z. Kuçi do ta sillte kështu:

Shkolla Ushtarake "Skënderbej"

Në shtator 1971 fillova shkollën ushtarake "Skënderbej" në Tiranë, të cilën e vlerësova privilegj, duke e krahasuar me vështirësitë e shkollës tetëvjeçare. Në këtë muaj dhe vit, ndërrova status nga civil në ushtarak, nisa një jetë ndryshe, shkollë dhe disiplinë të rreptë. Shkolla "Skënderbej", me programin e saj të larmishëm, me trupën pedagogjike të përzgjedhur, të përkushtuar, si ushtarakët dhe mësuesit civilë, formonte me dinjitet oficerët e ardhshëm të llojeve të forcave të RSH-së. Më duhen shumë faqe për të shkruar ç' ka ndje sot pas kaq vite formimi, eksperience kudo në vendin tim dhe në botë për këtë shkollë të mrekullueshme, plotësisht në standard me vendet perëndimore. Aty kuptova artin e të mësuarit, matematikën, fizikën, kiminë dhe letërsinë; aty mësova artin ushtarak, por mbi të gjitha u formova me ndjenjën e sakrificës, guximit, të besimit, të vullnetit për t'i shërbyer vendit tim ku ai më kërkoi, por edhe në profesion të vështirë, duke pilotuar avionë supersonikë. Në këtë rrëfim të shkurtër do t'i shmangem cilësimit emër për emër, ata janë të gjithë njësoj-të shkëlqyer. Nga mësuesi kujdestar, profesori i talentuar i matematikës Asimaq Proko, deri tek drejtuesit e shkollës, civilë dhe ushtarakë. Mirënjohje për këtë shkollë, për ata që më mësuuan profesionin në uniformë ushtarake, për t'i shërbyer ndershmërisht vendit tim.

Shkolla e Lartë e Aviacionit, Vlorë

Në vitin 1975 u përzgjedha nga ekipi vlerësues mjekësor për pilot, realizova një ëndërr të kohës të fëmijërisë, Shkolla "Skënderbej" ma dha këtë mundësi. Rrugëtimi i vështirë, pasion dhe guxim, drejt Shkollës së Lartë të Aviacionit, Vlorë.

Baza ajrore ishte jo shumë larg vendlindjes sime dhe avionët zhurmonin përherë mbi fshat. Edhe unë si çdo fëmijë ëndërrimtar thurja lloj-lloj fantazirash kur shikoja një grusht hekura diku në qiell mbi kokat tona. Nuk besoja që këtë përbindësh ajror një ditë do ta drejtoja edhe unë, duke bërë zhurmë dhe në fshatin tim mbi Berat, ku unë u rrita me kokën drejt qiellit.

Shkolla e Lartë e Aviacionit, për nga misioni i saj ishte një shkollë e vështirësisë maksimale. Që në fillim të afronte emocione të forta dhe disi të paqarta që sillleshin të vobullta në mendjen e çdo studenti deri edhe tek mosbesimi për t'u bërë pilot. Ishim skënderbegas kur filluam analizat mjekësore. Pa e shijuar mirë gëzimin e seleksionimit të rreptë nga ekspertiza mjekësore për fluturim në Spitalin Ushtarak Tiranë; shpejt u informuam se në fund të katër viteve shkollë të aviacionit, diplomoheshim më pak se 50% të studentëve, përqindje që sillte dyshime dhe mosbesim. ...Kështu na ndryshoi ai entuziazëm adoleshenti, skënderbegas, në sytë tanë pa filluar studimet. Moralisht patëm fatin e keq, pasi në fillimin e vitit tonë akademik erdhën në mbrojtjen e diplomës 5 pilotë nga 30 vetë të fillim vitit të tyre. Kështu ne i filluam studimet me frikën e seleksionimit, që vinin nga refleksi për fluturim dhe nga një mori faktorësh të tjerë negativë që ndikonin në të. Pas një seleksionimi të rreptë në avionin Tip 61, fillonte viti i tretë akademik për të përfunduar programin në avionin reaktiv. Programi parashikonte përdorimin luftarak të avionit në qitje/bombardim, luftim ajror, kapje dhe sulme tipike, ndaj dhe seleksionimi ishte për të formuar pilotë në avionët supersonikë. Republika e Shqipërisë e mbështeste ruajtjen e hapësirës ajrore parimisht në të gjitha tipat e avionëve që ajo kishte në shërbim, por vendimtarë ishin avionët supersonik Mig-19/21. Shkolla duhej të përgatiste pilotë për të fluturuar në Mig 19/21, prandaj selektimi ishte i rreptë, parashikues, pa alternativë vijuese. Diplomohej më i miri për të shkruar në regjimentet luftarake. Fatmirësisht edhe unë isha nga të pakët që kalova këtë provë, u diplomova "Pilot Gjuajtës -Bombardues".

Më 27 korrik 1980 u diplomuan 13 pilotë dhe një parashutist. Ishte një sukses për Akademinë, pasi zakonisht mbaronin shumë pak studentë. Në avionin Mig 19 kaluan 10 vetë, unë isha midis tyre.



Kam bërë më shumë se 14 vjet fluturim në detyrën e Komandantit të Ekuipazhit në avionët helikë/reaktivë Jak 18, Mig-15, Mig-17 dhe në avionin supersonik Mig-19 në Bazat Ajrore: Vlorë, Kuçovë, Gjadër dhe Rinas. Në ditën e largimit nga pilotimi i avionit, pas uljes së fundit me avion Mig 19, hodha në librezën e fluturimit, si dokument "top sekret" i pilotit, këto rreshta i sapo ardhur nga fluturimi:

"Na besuan me vete në çdo fluturim, me/pa eksperience, një arsenal të madh armatimi: raketa, bomba dhe predha. I kishim butonat e kuq jo më larg se 1-2 cm nga gishtërinjtë që drejtonin dorezën e komandimit të planerit të avionit dhe të motorit... Në avionët luftarakë, aty rreziku është pasagjeri më i frekuentuar, i ulur fare pranë sediljes të fluturimit, të pranuar dhe miratuar nga vet ti, për më tepër ti e bën rrezikun me shumë pasion - profesion të jetës. Na besuan dhe na lidhën pranë sediljes katapultuese në një mjet fluturues njëvendësh, të njohur vetëm teorikisht në tokë, edhe pse vendet e lindjes e quanin "arkivol fluturues". Gjatë rrugës ne humbëm shumë shokë, por nuk u thyem, ne u ngritëm në ajër dhe realizuam detyrën në perfekcion, detyrë të cilën e kishim marrë përsipër për ta bërë në emër të atdheut edhe pse ishim fare të rinj.

Në periudhën shtator 1990-1992, kreu studime pranë Akademisë së Mbrojtjes në Tiranë, të cilat plotësuan tërësisht formimin tim si ushtarak, ndjehesha i aftë të kontribuoja në shtabet e forcave tona. Mbas mbarimit të akademisë erdhi për mua një karrierë ushtarake në rritje, u vlerësova. Kam mbajtur disa detyra të rëndësishme në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në Ministrinë e Mbrojtjes si Shef i Stërviçes të Forcave Ajrore, Tiranë; Shefi i Shtabit të Bazës Ajrore, Kuçovë; Zëvendëskomandant i Akademisë të Forcave Ajrore, Vlorë;

Kolegji Gjitharmësh i Mbrojtjes në Paris

U përzgjedha nga ambasada franceze nga 30 kandidatë oficerë të tre llojeve të forcave të gradave n/ kolonel e kolonel, duke kaluar një provim të vështirë. Në periudhën janar 1998-1999, kreu Kolegjin Gjitharmësh të Mbrojtjes në Paris në një konkurrim të fortë me oficerë nga 96 shtete të botës. Nisur nga rezultatet e kësaj akademie Ministria e Mbrojtjes franceze filloi plotësimin e dosjes për dekorim nga Presidenti i Francës. Programi gjitharmësh i kësaj akademie më dha mundësinë të fluturoja në avionët 'Mirage' dhe 'Alpha-jet' me mision njohje të teknologjisë aeronautike. Krahas programit në vitin 1998 dhe në 1999 përgatita dy tema gjeopolitike dhe gjeo-strategji, të debatueshme për nga përmbajtja për situatën aktuale. Disa muaj para, kur bota, UÇK-në e quante rebele, studimi im: "E panjohura shqiptare në ekuacionin ballkanik" argumentonte se "Lufta kishte filluar ...", u desh fillimi i bombardimit, më 24 mars 1999, që unë të fitoja vlerësim maksimal. Për nga gjerësia e lexuesve dhe shpërndarjes së informacioneve do t'i konsideroja të rëndësishme, pasi ato janë hedhur në intranetin e këtij institucioni akademik dhe të MM të Francës. "Strategji e re e integritit të Shqipërisë në Evropë"; «La nouvelle stratégie d'intégration de l'Albanie en Europe», 18 faqe. Mémoire de géopolitique: "L'inconnue albanaise dans l'équation balkanique"; "E panjohura shqiptare në ekuacionin ballkanik", 35 faqe. Po kështu me konkurrim dosje u përzgjedha për Studime Aeronautike, Institutit Francez i Sigurisë Ajrore në Paris (anglo/francez) dhe më pas kreu (part-time) Akademinë Diplomatike Shqiptare, Tiranë.

Bazuar nga formimi dhe eksperiencia në vite, Ministria e Mbrojtjes më vlerësoi me detyra të rëndësishme: Pedagog në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë; Shef Sektori i Strategjisë në Shtabin e Përgjithshëm, Tiranë; Këshilltar i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura; Analist/Koordinator në Qendrën Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Në varësi të këtyre detyrave për përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe të integritit të forcave tona për në NATO, Ministria e Mbrojtjes më akordoi disa kurse afatshkurtra Doktrinë/Strategji: SHBA, Holandë, Hungari, Gjermani, Kroaci.

Rruga drejt Ambasadës, me emocion, e bukur por edhe e vështirë...

Bazuar në eksperiencën e fituar në vite dhe formimin jashtë vendit u përzgjedha si Atashe i parë i Mbrojtjes për të hapur misionin ushtarak pranë Ambasadave të RSH-së në Francë dhe në Portugali, nga gushti 2006 deri në dhjetor 2010. Në dokumentin shtetëror zyrtar shkruhet: "Misioni Ushtarak për RSH-në në Paris u hap për herë të parë, më 05 shtator 2006. Atashe i Mbrojtjes, kolonel Zaim Kuçi".

Pas një rruge të gjatë, veshur me uniformën e forcave tona të armatosura, erdhi momenti i shumëpritur për të ndryshuar fushën e veprimtimit, nga detyra të mirëfillta ushtarake në diplomaci-bërje në fushën e diplomacisë së mbrojtjes. Vlerësova se po marr një përgjegjësi tjetër, të re dhe në një terren të panjohur.

Duhej filluar nga "0"-ja, me ndryshim të mentalitetit tek kolegët dhe eprori në ambasadë, deri në pajisjen me apartament banimi, zyrë dhe kushte të tjera për punë. Më duhej të prezantoja në këtë terren pa njohje se çfarë përfaqëson një diplomat ushtarak, rolin dhe pozicionin i tij hierarkik në ambasadë. Po aq i vështirë për mua si fillim ishte dhe prezantimi, paraqitja dhe zënia e vendit në mjedisin francez dhe në atë



Dëshmoj për gjeneral Thoma Xhixhon

(Në kuadrin e 65-vjetorit të AFA-së)



SHEH HYSEN ALI HORMOVA*

Vlerat e librit janë maksimale

Kur mora librin “Gjeneral Thoma Xhixho, i pari komandant i Akademisë Ushtarake Shqiptare”, në kopertinë gjendej fotografia e gjeneralit. U emocionova, sepse dukej i gjallë, i bukur dhe me shikimin atje larg, që tregojnë largpamësinë dhe vizionin e tij. E putha dhe mora frymë thellë, më dukej sikur e kisha pranë. Të mos ta fsheh, e humba qetësinë dhe dola paksa nga vetja.

Unë kam qenë pjesë e dëshmimeve për gjeneralin.

Aty ku gjenerali ka qenë komandant i shkollës dhe Enver Begeja shef Shtabi, e pata fatin që edhe unë të ngjitem në detyrën e Shefit të Shtabit të Shkollës, patjetër shumë vjet pas tyre.

E mora librin dhe për katër ditë e “përpiva” dhe në çdo faqe lashë nga një shenjë. Pasi e mbarova librin, i kënaqur me mënyrën e trajtimit thashë: “Është shumë e vështirë, por edhe e lehtë për të bërë një jetëshkrim për një personalitet të madh si gjeneral Thoma Xhixho”.

Pse është e vështirë?! ... Është e vështirë sepse kur nisesh të vësh vetulla nxjerr sytë, pra mund të dështosh, por falë penës së artë të Bernardit (Zotaj) që ia arriti qëllimit dhe vlerat e librit janë maksimale.

Po pse është e lehtë?! ... Kur subjekt ke një personalitet, je i çliuar, pra kur e ke brumin e gatuan si të duash, mjafton pena e Bernardit dhe produkti del i shkëlqyer.

Nuk ka vlera të mëdha dikush që ka marrë këtë titull se ka kënduar bukur labçen, por kur këtë titull e merr një luftëtar dhe shkencëtar i Artit Ushtarak; një patriot që tërë jetën e shkriu për atdheun dhe popullin, vlerat e titullit nuk nderojnë vetëm atë që e merr këtë titull, por nderon edhe Qarkun e Gjirokastrës për nderin që po i bën biri i saj, që vetë e lindi dhe e rriti.

Ndryshimi i arritjeve duhet trajtuar në materiale

... Ishte viti 1972 në Akademinë Ushtarake. Unë student i vitit të dytë, gjenerali, kështu e thërrisnim ne, edhe pse gradat ishin hequr, ishte zëvendëskomandant dhe shef i Këshillit Shkencor, ndërsa komandant ishte

Vaskë Gjino.

Do të bëhej një takim me studentët dhe pedagogët në praninë e ministrit të Mbrojtjes Beqir Balluku. Mua si student i vitit të dytë Artileri Tokësore, më kishin caktuar që të diskutoja. Orientimi ishte mbi programet e Akademisë. Më parë, shefi i Katedrës së Artilerisë Ritvan Dishnica dhe Mustafa Novi, të dy shkencëtarë të Artilerisë, më kishin instruktuar me pika se ku duhet të përqendrohesh, por pa ma diktuar idenë e tyre nëse programet ishin të mira, sipas tyre.

Pasi kumtova ligjëratën time, Beqir Balluku tha: “Shumë mirë, tani më thuaj, e para, këto programet që më the a kanë ujëra dhe a duhet të pasurohen më tej? E dyta, sa orë studion ti dhe kur fle në darkë?”

- Shoku Ministër, çdo gjë që është e vjetër, përpara të reja të shkencës, çdo armë e re dhe çdo ndryshim i arritjeve të ushtrive të huaja, patjetër duhet trajtuar në materialet tona të përgatitjes.

- Mirë, mirë po si janë ato? - tha ai.

- Ne na duken mirë-formuese dhe na aftësojnë për drejtimin e komandave dhe shtabeve.

- Aaa, - bëri ai, - ma fshehe mendimin që pate! Ato kanë ujëra - qeshën të gjithë, ndërsa unë u skuqa në fytyrë.

Kur dolëm përjashta në pushimin e seancës së parë, mua më kishin rrethuar pedagog Ritvani e Mustafa Novi, ndërsa pak më tutje Ministri me Vaskë Gjimon dhe Thoma Xhixhon.

Gjeneral Thomai ia bëri me dorë Ritvanit dhe Mustafait:

- Hajdeni këtu. Thomai u tërhoq pak nga Ministri dhe u tha atyre: -

Këtë djaln (mua më tërhoqën me vete kur i thirri gjenerali), mbështeteni dhe mbajeni afër në katedrat tuaja.

Kur u futëm në seancën e dytë, Beqir Balluku tha:

- Ç’u bë ai studenti që unë e pyeta?

Unë u ngrita në këmbë.

- More nuk më the, sa studion ti dhe kur fle natën?


Unë i thashë se studioj shumë dhe gjumë fle në orën 12.00, (këtu e gënjeva se ora 22.30 ne studentëve na gjente në krevat).

- Turp, turp, - tha ai.

- A e dini ju, se këta që janë mbrapa meje, ishte fjala për ata që kishin mbaruar në BS, e gdhinin tërë natën, kurse ju flini që në orën 12.00?

Mbajeni ushtrinë...

...Bëhej një stërvitje e madhe në bregdet. Ministër Mbrojtjeje ishte Mehmet Shehu. Stërvitja me trupa zhvillohej në Manzë, aty pranë gjirit të



Lalëzit. Tema: “Brigada e Këmbëorisë në skalion të dytë të Korpusit për asgjësimin e kryeurës së armikut”.

Unë dhe komandanti i shkollës, Arseni Stroka, kishim detyrën për të organizuar zbulimin, praktikisht në dinamikën e luftimeve që do bëheshin, në pikën e vrojtimit që ndiqte kjo stërvitje ishte Mehmet Shehu. Së bashku me të ishin plot ish-gjeneralë dhe shkencëtarë ushtarakë. Njëpërmjet radios na vjen një urdhër: “Shefi i shtabit të imitimit (bëhej fjalë për mua), të vijë në pikën e vrojtimit”. Unë u trondita sepse do të shkoja para Mehmet Shehut. Arseniu më thotë: “Hysen mos u impresiono, ti situatën e di dhe imitimet që do të bëhen sipas luftimit i ke të qarta. Mos u huto. Ik, dalsh faqebardhë!”

Rregullova uniformën, rripin e mesit, radion që komandonim zbuluesit dhe dylbitë dhe u ngjita tek vendi ku dhe Mehmet Shehu. Ju paraqita sipas rregullit ushtarak. Ai me atë tonin e tij prej ushtaraku të mirëfilltë, më tha: “Më thuaj në vija të trasha idenë e të dy palëve”. Fillova dhe paraqita vijën e armikut ku ishte ndalur dhe ku ishin

dislokuar forcat tona. Ai pasi mori këtë informacion, vazhdoi: “Po zbulimin si e keni organizuar? Mos më bëj teorira, por praktikisht!”

Unë: “Si urdhëron!” Hapa butonin e radios dhe komandova: “18-a, çohu!” (zbuluesve u kishim vendosur nga një numër sipas vijave të luftimit dhe ishin të maskuar). Aty para nesh, 4-5 metra larg, doli nga një gropë një ushtar i zhveshur dhe i lyer me baltë, që nuk dallohej nga terreni (baltë e kuqe). Mehmet Shehu, duke tundur kokën tha: “Bravo, ik, ik!” Unë i impresionuar dhe i kënaqur u largova.

Në këtë moment, në largim e sipër në supin tim ndjeva një dorë dhe një zë: “Të lumtë, na nderove!” Kjo dorë dhe ky zë ishte i gjeneral Thoma Xhixhos. Ai zë më thoshte: “Mbajeni ushtrinë, se populli u ka zgjedhur për ta mbrojtur!”

Këto dy ngjarje që u tregova janë një postulat amaneti dhe kujtim i pashlyeshëm me gjeneral Thoma Xhixhon.

Mësime të shenjta

Pasi e mbarova librin, ktheva në retrospektive dhe gjumi nuk më zinte. Aty shtrirë flisja me vete po dhe me

shpirtin e gjeneralit. Në ëndërr, sikur i thosha gjeneralit disa mësimë të shenjta:

“Gjeneral, jeta është një himn-këndoje! Ti e këndove si me grykën e pushkës dhe me mendje, ti e këndove në podiumet akademike, por e këndove edhe në stërvitjet e mëdha me trupa! Jeta, gjeneral, është një shans-kape! Ti e kape, e kape që kur vendose të ishe anëtar i njësitit gueril të fshatit Suhë, por edhe më vonë komisar e komandant në formacionet partizane!

Jeta është një sfidë-sfidoje! Gjeneral, ju çdo situatë e sfiduat! Ty nuk të trembi plumbi kur u plagose, por sa u shërove vazhdove në tym e në flakë. Edhe kur t’u bënë provokime ti i sfidove; ti i sfidove ata që minoritarët i dallonin nga vendasit, ndërsa ju i trajtuat minoritarët si vëllezër me të drejta të barabarta, që me urdhrin tuaj ata zinin pozicionet e zjarrit në provokacionet greke të gushtit 1949.

Jeta, sipas mësimëve të shenjta, është detyrë-kryeje! Të cilën ju e zbatuat me dinjitet e korrektesë, por keni pasur edhe raste që nuk e keni zbatuar ndonjë detyrë, edhe pse moszbatimi ty të rrezikonte, kur ajo detyrë ishte në kundërshtim me interesat e mbrojtjes. Rasti konkret ishte kur të thirri Hysni Kapua për të të dhënë një detyrë në Grupimin e Tiranës dhe ju kundërshtuat, se s’kishit qenë dakord me strukturën organizative që do bëhej. Kjo tregon se ju e keni luftuar dyfytyrësinë.

Jeta është mister-zbuloje gjeneral! Vërtet ju e zbuluat çdo gjë dhe nuk e latë misterin të mbetej në errësirë. Praktikisht, në tezat e zeza kur dikush të tha distancohu nga formuluesit e tyre, ju me dinjitet e kompetencë nuk pranuat të binit në grackën e ngritur, por me dijet tuaja bëtë disa shtesa për të thënë se duheshin edhe këto etj. Të lumtë, kolosi i mendimit filozofik ushtarak!

Juve gjeneral keni pasur forca të ngriheni, kur padrejtësisht ju kanë rrëzuar; dijet tuaja i kanë thyer edhe vendimmarrje. Ty, krijuesi i Akademisë së Lartë me kuadro e literaturë, më vonë të emëruan zëvendëskomandant në atë Akademi që ti vetë e krijove. Ti jo vetëm nuk shfaqe pakënaqësi, por vazhdove me zell punën shkencore, sepse detyra jote sipas betimit tënd akoma nuk qe plotësuar. Njeriu vdes kur harrohet, ti nuk ke vdekur dhe do të kujtohesh në brez!

Tek ty do të mbështeten vazhduesit e misionit tënd!

**Ish-student i gjeneralit dhe zëvendëskomandant i Shkollës së Bashkuar të Oficerëve*

diplomati të akredituar në Paris. Përgjegjësia ime rritej më tepër dhe për faktin që, deri në vitin 2006, kohë kur unë mora këtë mision, Ministria jonë e Mbrojtjes kishte shprehur vullnetin e saj për një plan bashkëpunimi, por pala franceze nuk ishte përgjigjur. Ajo ishte mjaftuar vetëm me ato pak aktivitete rutinë në vit edhe pse kishte hapur që prej 10 vitesh misionin ushtarak në Tiranë. Në atë fillim detyre, për mua të qenit diplomat, ishte në klasifikimin ‘i vështirë’, pasi për herë të parë hapej misioni ushtarak në Paris. Sipas vlerësimit tim, jam shprehur në shtyp se të jesh diplomat i mirë, do të thotë që ta konsiderosh vërtet detyrë të vështirë: “më të vështirë se pilotimi i avionit ‘Mig’, e cila ka qenë pjesa më e kushtueshme e jetës time”, thënie kjo që më dhuroi ironinë e miqve të mi pilotë. Fakti që në Francë janë akredituar atashetë e më shume se 90 shteteve të botës, me një nivel të lartë përfaqësimi (në mbi 25 gjeneralë), kërkon një paraqitje dhe vëmendje të veçantë. Unë i mirëkuptova ata. Për një pilot supersonik si dhe për mua ishte absurditet të krahasohej dhe të pranohej këtë thënie, por mësova se edhe diplomacia ka momente “shtoper”, nëse nuk je i përgatitur, nëse nuk ke dhe nuk bën po atë kujdes si në pilotimin e avionit, shumë shpejt bie në pozicion të panjohur të avionit, aty maten fjalët në fjalë. E vlerësova këtë detyrë, jo vetëm si diplomaci ushtarak, por një mundësi përfitimi ekonomik,

një diplomaci e kujdesshme e sjell atë; e vlerësova si dekoratën më me vlerë të karrierës time ushtarake, unë arrita të përfaqësoj vendin tim në tempullin e diplomacisë botërore.

Fillimi i detyrës me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral Henri Bentegeat

Në tetor 2006, bëra takimin e parë zyrtar me autoritetin më të lartë të Forcave të Armatosura franceze. Pasi më uroi për detyrën dhe shkëmbyem fjalët e rastit, u interesua për sistemimin tim dhe të familjes. I pohova: “Z. Gjeneral, kam ardhur me optimizëm të bëj detyrën në interes të dy vendeve tona, ky entuziazëm është me të gjithë ata që fillojnë për herë të parë, ka entuziazëm, por për mua fillimi është një shqetësim; nuk kemi një plan bashkëpunimi, krijohet përshtypja sikur nuk punoj, aq më tepër unë vij nga një armë e vështirë që kërkon punë... Ju falënderoj shumë për pritjen dhe ju kërkoj falje për kohën e çmuar që harxhoni me mua, por do të përfitoj nga ky takim për t’ju thënë miqësisht se midis RSH-së dhe Francës, nuk ka akoma një plan bilateral. Zoti gjeneral, ne pilotët jemi dhe një çikë të drekt, kur mendojmë se kemi të drejtë, i themi gjërat pa shumë diplomaci. Hapja e misionit për të parën herë në Paris, sigurisht ka dhe interesim të veçantë nga eprorët e mi. Jemi vend frankofon, nuk jemi grekofon apo italofoon si vende fqinjë që i kemi, ndaj Francën e kemi

prioritet, aleatë në rrugën që kërkojmë të integrohemi. Unë kam punuar në J5 dhe ne kemi pothuajse plan bilateral me të gjithë vendet e NATO-s, me Francën nuk kemi. Gjatë kohës si këshilltar i Shefit të Shtabit pritëm të gjithë shefat e shtabeve të rajonit dhe të vendeve te NATO-s, por jo shefin e shtabit të Francës!” Kuptova se në këtë prezantim isha direkt, pa luster diplomacie. Mikpritësi vazhdoi: “Kolonel, shikoj se një pilot shumë shpejt është bërë diplomat. Ju premtoj se, të dyja këto çështje, që për atashëun shqiptar janë shqetësim, do të realizohen së shpejti. Ju e keni lobingun në MM dhe SHP të Francës, dy shokë grupi francezë i keni në poste të rëndësishme!” Kështu shumë shpejt u nënshkrua plani i parë bilateral me Francën me 15 aktivitete, realizimi i të cilave sillte përfitim nga mbështetja e Francës për integrimin në NATO/BE si dhe në logjistikë. Nga ky plan, RSH përfitoi nga Franca mbështetje të konsiderueshme ekonomike, operacioni u mbështet plotësisht nga forcat franceze, ishte një sukses përtej dhe parashikimeve. Kam qenë Këshilltar dhe Koordinator pranë Shtabit të BE-së (“Mont Valerien”) dhe të Forcave të Armatosura Franceze për Operacionin e Çadit, 2009-2010.

Dëshirova, ndjeva dhe u obligova institucionalisht, me atributet e koordinitorit, për këtë operacion, për të mundësuar angazhimin konkret të vendit tonë në operacionet e udhëhequra nga BE. Komandanti i Operacioneve të BE-së, ishte gjeneralletënant Patrik NASH (irlandez).

Udhëtimi historik i 'shqipeve' mbi trojet shqiptare

Hapi i parë për të krijuar një Aviacion Ushtarak në Shqipëri u hodh në vitin 1914, kur qeveria shqiptare porositi blerjen e tre avionëve "Lohner Daimler" nga Austria, për të formuar Korpusin Ajror Shqiptar.

Si rezultat i Luftës së Parë Botërore, urdhri u anulua. Në vitin 1920, në Shqipëri janë bërë përpjekje për të organizuar Aviacionin Ushtarak. Në nëntor 1929 u dekretua "Ligji mbi organizimin e Fuqive Armate", sipas të cilit ushtria emërtohej "Ushtria Kombëtare Shqiptare" dhe ndahej në "Fuqitë Tokësore, Detare e Ajrore". Por Forcat Ajrore nuk arritën të krijohen.

Krijimi i flotës ushtarako-ajrore

Shteti shqiptar bëri përpjekje të shumta për krijimin e armës së aviacionit luftarak, por për arsye politike një gjë e tillë nuk u arrit dot deri mbas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1945, një grup ish-partizanësh filloi përgatitjen për pilotë luftarakë në shkollën e aviacionit jugosllav. Ky grup përbëhej nga Niko Hoxha, Edip Ohri, Fahri Bubësi, Pertef Myftari, Ibish Vokshi, Zyhdi Rada, Sazan Xhelo, Irakli Grazhdani, Masar Aga, etj., pas prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, grupi e vazhdoi përgatitjen në Bashkimin Sovjetik.

Aviacioni Luftarak Shqiptar u krijua pas Luftës së Dytë Botërore. Pas vitit 1945 u hodhën hapat e parë për krijimin e armës së aviacionit, duke përgatitur grupet e specialistëve, pilotëve dhe teknikëve në Jugosllavi. Grupi i parë ka mbaruar në vitin 1949. Grupi i dytë është përgatitur në ish-Bashkimin Sovjetik.

Më pas pilotët do të përgatiteshin



në Vlorë ndërsa disa prej tyre do të specializoheshin në Kinë. Aviacioni Luftarak Shqiptar u krijua më 24 prill të vitit 1951, kur piloti shqiptar Peço Polena fluturoi me një avion të Forcave Ajrore, të montuar e përgatitur nga specialistët shqiptarë.

Repartit i parë ushtarak i aviacionit

u krijua në Tiranë në vitin 1951, në Aerodromin e Laprakës.

Regjimenti i parë i Aviacionit Reaktiv u krijua në vitin 1955 në Kuçovë. Ai do të pasohet më pas me krijimin e Regjimentit të Rinasit, Shkollën e Aviacionit, Regjimentin e Helikopterëve në Farkë dhe Regjimentin

e Gjadrit.

200 avionë për të mbrojtur "ajrin"

Në vitet '70-'80, Aviacioni Luftarak kishte në efikasitet të plotë mbi 70 avionë MIG-19 dhe 12 avionë MIG-21, një skuadrilje luftarake me 12 avionë MIG-17 dhe shumë avionë luftarakë-mësimorë të tipit MIG-15, 4

avionë transporti IL-14 për transport qeveritar, apo për studime ushtarake dhe gjeografike.

Në Tiranë, në Aerodromin e Laprakës ishin të dislokuar edhe 12 avionë transporti të lehtë AN-2 për transport trupash, apo në ndihmë të ekonomisë, ndërsa në Shkollën e Lartë të Aviacionit në Vlorë, veç avionëve reaktivë MIG-15 kishte edhe dy skuadrilje me avionë me helikë JAK-18, që shërbenin për përgatitjen e pilotëve në vitin e parë të kualifikimit si pilot. Në Farkë ishin rreth 36 helikopterë MI-4. Në Rinas kishte gjithashtu edhe 1 (një) avion bombardues të lehtë tip IL-28.

Organizimi

Në fillimet e tij e deri në vitin 1974, aviacioni ka qenë pjesë e Komandës së Mbrojtjes Kundër Ajrore të Shtetit Shqiptar, ku komandanti i aviacionit ishte njëherazi zëvendëskomandant i MKA-së. Komandanti i parë i aviacionit ka qenë Kolonel Edip Ohri, i cili e ka komanduar atë deri në vitin 1974. Aviacioni ka qenë komandë më vete, deri në vitin 1995, kur aviacioni u bë pjesë e Forcave të Mbrojtjes Ajrore. Nga viti 1975 e deri në vitin 2005, komandantë të aviacionit kanë qenë Bardhyl Taçi, kolonel Klement Aliko, gjeneral Perlat Binaj, gjeneral Astrit Jaupi.

Fundi i avionëve supersonikë

Edip Ohri, komandanti më jetëgjatë i aviacionit, prej më shumë se 20 vjetësh, ka firmosur për futjen e të gjithë avionëve në Shqipëri, nga viti 1951 deri në vitin 1974. Pas kësaj kohe Shqipëria nuk ka marrë më avionë. Gjeneral brigade Astrit Jaupi ishte komandanti me firmën e të cilit avionët MIG ndaluan së fluturuar, në nëntor 2005, pas një aksidenti tragjik në aeroportin e Rinasit. Mbas 30 vjetësh shërbimi, MIG-21 u cilësua si teknologji e prapambetur. Por nuk ishte vetëm kjo. Pas ngjarjes së ndodhur në shtatorin e vitit 2004, ku në Rinas u rrëzua me avionin e tij piloti dëshmor, Jani Tarifa, u vendos kategorikisht që të ndaloheshin fluturimet. Në nëntor 2005 kur u mor ky vendim u lanë në konservim si rezervë për fluturim: 2 Mig-21, 8 Mig-19, 4 Utimig-17, 6 Mig-17 dhe 4 AN-2.

Fluturimet e avionëve në monizëm

Të paktën 240 ishte numri i mjeteve fluturuese, që përbënin Armën e Aviacionit Luftarak. Një shifër të tillë e ka konfirmuar gjeneral brigade Astrit Jaupi, ndërsa ishte në krye të aviacionit.



Avioni i parë shqiptar



Edip Ohri, gjithashtu gjatë një interviste ka përmendur shifrën e 200 avionëve luftarakë. Padyshim Ohri nuk ka futur helikopterët dhe avionët mësimorë, që përdorte shkolla e aviacionit, të cilat e rrisnin ndjeshëm numrin e mjeteve fluturuese që Shqipëria kishte në dispozicion.

Sasia e avionëve dhe helikopterëve deri në vitin 1990

95 avionë MIG-19-S, 12 avionë MIG-21, 12 avionë MIG-17, 3 avionë IL-14 për shërbime qeveritare, 1 avion bombardues IL-28, 36 helikopterë MI-4, 12 avionë AN-2 transporti, 24 avionë JAK-18, 4 avionë "Po-2", 1 oficinë për kapitalin e të gjithë tipave të avionëve që posedonte Shqipëria.

Data historike për aviacionin nga lavdia në shpërbërje

Edhe vëzhgimi i hapësirës ajrore është institucionalizuar pas luftës. Më 14 shkurt të vitit 1947 është krijuar kompania e VAIN-it për vrojtimin e hapësirës ajrore dhe informimin për objektet e zbuluara.

Grupimi i parë i avionëve luftarakë është bërë në Tiranë në vitin 1951, ku bënë pjesë avionë PO-2 dhe JAK-18.

Reparti i parë i aviacionit reaktiv është krijuar në vitin 1955 në Kuçovë dhe kishte në përbërje të tij avionë MIG-15.

Në vitin 1957 krijohet reparti i transportit ushtarak në Tiranë, i cili kishte në përbërjen e tij avionë Po-2, JAK-18 dhe helikopterë MI-1 dhe MI-4.

Në vitin 1962 u krijua regjimenti i aviacionit në Rinas, i cili kishte në përbërjen e tij një skuadrilje me avionë MIG-19 dhe një skuadrilje me avionë MIG-17. Po në vitin 1962 krijohet edhe shkolla e aviacionit.

Në vitin 1967 krijohet regjimenti i helikopterëve, që numëronte në parkun e tij mbi 30 helikopterë të rinj MI-4.

Në vitin 1974 krijohet regjimenti i Gjadrit, i cili ishte i pajisur me avionë MIG-21 dhe MIG-19, përveç disa avionëve mësimorë MIG-17 e MIG-15 për trenerim.

Në vitet '70 aviacioni luftarak kishte në efikasitet të plotë mbi 70 avionë MIG-19 dhe 12 avionë MIG-21, një skuadrilje luftarake me MIG-17 dhe shumë avionë luftarakë-mësimorë të tipit MIG-15. Pjesë e parkut ushtarak të avionëve ishin edhe katër avionë transporti IL-14, të cilët shërbenin si avionë për transport qeveritar apo për studime ushtarake e gjeografike.

Në Tiranë, në fushën e Laprakës ishin të dislokuar edhe 12 avionë transporti të lehtë AN-2, që shërbenin

për transport trupash dhe në ndihmë të ekonomisë. Në shkollën e lartë të aviacionit në Vlorë, veç avionëve reaktivë MIG-15, kishte gjithashtu edhe dy skuadrilje me avionë me helikë JAK-81, të cilët shërbenin për përgatitjen e pilotëve në vitin e parë të kualifikimit si pilot. Në Regjimentin e Rinasit kishte gjithashtu edhe një avion bombardues të lehtë tip IL-28.

Në vitet '70-'80 niveli i programimit të fluturimeve ishte intensiv dhe sasia e fluturimeve për çdo pilot e avion ishte i

standardeve e kërkesave të larta.

Pas viteve 2000, në Forcat Ajrore filloi prurja e teknikës fluturuese Perëndimore.

Në prill të vitit 2001 erdhën helikopterët e parë AB-206, ndërsa më 26 nëntor 2003 është kompletuar një skuadrilje e tillë.

Më 24 prill 2004 erdhi helikopteri i parë AB-205.

Më 1 shkurt të vitit 2007 erdhi helikopteri për transport VIP A – 109.

Më 18 qershor 2007 erdhën

helikopterët e parë BO – 105.

Më 28 korrik 2012 erdhi helikopteri EC-145, i versionit VIP.

Më 3 dhjetor 2012 erdhi helikopteri i parë shumë-funksional tip 'Cougar'.

Më 25 prill 2013, vjen helikopteri i dytë shumë-funksional tip 'Cougar'.

Më 18 dhjetor 2013, vjen helikopteri i tretë shumë-funksional tip 'Cougar'.

Më 27 tetor 2014, është futur në përdorim të Forcës Ajrore helikopteri i katërt tip 'Cougar'.

Më 31 tetor 2015, hyjnë në përdorim në FA dy helikopterë EC-145.

Aviacioni me 43 dëshmorë

43 ushtarakë të armës së aviacionit kanë rënë në krye të detyrës dhe janë shpallur "Dëshmorë të Atdheut". Me vendim të Qeverisë Shqiptare, që nga data 24 prill e vitit 2003, ata prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë dhe në rrethe.

Kush kanë qenë drejtuesit e lartë

Mbrojtja Kundërajrore dhe Aviacioni janë "takuar e ndarë" disa herë nga forma organizative, por bashkëpunimi i tyre ka qenë gjithnjë i pashkëputur. Në fillimet e saj, arma e Aviacionit ka qenë pjesë e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore, gjë që ka vazhduar deri në vitin 1974 për t'u bashkuar përsëri në Forcat e Mbrojtjes Ajrore në vitin 1995. Komandanti i Parë i Aviacionit ka qenë z. Edip Ohri, i cili e ka komanduar atë deri në vitin 1974. Nga viti 1975 e deri në vitin 1995, komandantë të Aviacionit kanë qenë Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Perlat Binaj. Shumë ushtarakë të këtyre armëve, që kanë drejtuar e punuar në vite, janë nga figurat më të shquara të ushtrisë sonë, ku përmendim Rrahman Parllaku, Gjin Marku, Hito Çako, Todi Naço, Sotir Filto, Arif Hasko, Edip Ohri, Niko Hoxha, Babaçe Faiku, Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Haki Jupasi, Perlat Binaj, Salih Dibra, Haki Jupasi, Stefan Kagjini, Lulo Musai, Perikli Teta, Foto Lako, Harilla Rebi, Perlat Sula, gjeneral brigade Astrit Jaupi, etj., të cilët kanë qenë të njohur në të gjithë radhët e ushtrisë për kryerjen e detyrave.

Reparti i parë ushtarak i aviacionit u krijua në Tiranë në vitin 1951, në Aerodromin e Laprakës.

Regjimenti i parë i Aviacionit Reaktiv u krijua në vitin 1955 në Kuçovë. Ai do të pasohej më pas me krijimin e Regjimentit të Rinasit, Shkollën e Aviacionit, Regjimentin e Helikopterëve në Farkë dhe Regjimentin e Gjadrit.





F T E S Ë

Për të gjithë të rinjtë e të rejat, që ta shohin si një mundësi të re për veten, familjen po edhe atdheun, afrimin e tyre me Forcat e Armatosura të Republikës sonë. Pas rritjes së pagave me 30% në vitin 2022 dhe me 7% këtë vit, një tjetër rritje e konsiderueshme deri në 22% do të bëhet realitet në 2024, për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Respekt për punën e vajzave dhe djemve në uniformë, pjesë e vijës së parë të frontit në mbrojtje të territorit të vendit.

Kryeministri Edi Rama

